



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 09 / SHTATOR 2026

Nga zemra te zemra, fryma e bujarisë në Islam



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al

Viti XXXV i botimit

Nr. 09 (518)

Shtator, 2026


ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Rëndësia e pakrahasueshme e Kuranit
Mehmet Disha

në fokus

06 Tradita që bashkon, besimi që frymëzon, kultura që
ndërton të ardhmen / H. Bujar Spahiu

lajme / aktivitete

08 **01-Kryetari Spahiu pret në KMSH zyrtarë të ambasadës së SHBA-së në Tiranë**
02-Inaugurohet xhamia e re e lagjes Tophanë në qytetin e Shkodrës
03-"Trëndafili i Medinës" – Aktiviteti në përkujtim të jetës dhe veprës së Profetit Muhamed ﷺ
04-Përmbillet me sukses fushata "Paqe dhe Harmoni"
05-Fillon viti i ri shkollor 2026-2027 në mbarë vendin tonë
06-Myftinia Dibër zhvilloi simpoziumin "Të njihemi me Profetin Muhamed ﷺ"

refleksione

14 Falja e gabimeve dhe mosndjekja e të paditurve
Elvis Hymeraj

çështje fetare

16 Dhurimi i qumështit të gjirit në Islam
Këshilli për Çështjet Fetare - insi.al

familja

20 Një udhëtim mes dy dashurish
Jasmin Moxhahed

horizonti i besimit

22 Mënyrat e largimit të së keqes
Tauland Bica

24 Dija dhe karakteri në epokën e inteligjencës
artificiale / Haki Sahitaj

28 Modestia në Islam, stolia e besimtarit
Kliton Malaj

30 Përse kjo botë quhet "bota e provës"?
Bediuzzaman Said Nursi

32 Mëshira e Allahut
Abdullah Bulku

bota shpirtërore

34 Nga zemra te zemra, fryma e bujarisë në Islam
Dorian Demetja

hapësirë femërore

36 Dashuria e vërtetë
Hapësirë femërore

këndi i poezisë

38 Lulet nuk rriten pa vesë, zemrat nuk rriten pa lot.
Fatmir Muja



Rëndësia e pakrahasueshme e KURANIT

Një përkufizim përmbledhës, i përfutur shkurtimisht si hyrje nga dijetarët e fushës rreth librit të Allahut, Kuranit, është: “Kurani është të folurit e Allahut, është një mrekulli prej Tij që ja ka shpallur Muhamedit (a.s.), i shkruar në Mus’hafe, i transmetuar me besnikëri, kurse edhe vetëm leximi i tij është ibadet (adhurim), fillon me suren Fatiha dhe përfundon me suren Nas”.

Allahu (xh.sh), në Kuranin Famëlartë thotë:

“...Dhe lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë, sepse Ne do të dërgojmë vërtet një fjalë me peshë të rëndë”¹

“Sigurisht, ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht ne do ta ruajmë atë”²

“Ata që lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet. Që Ai (Allahu) do t’ju plotësojë shpërblimin e tyre, e edhe do t’ju shtojë nga mirësia e Tij, vërtetë Ai është Mëkatfalës dhe shumë Mirënjohës”³

Të gjitha këto janë janë vetëm prej disa nga ajetet të cilat tregojnë rëndësinë që Fjala e Zotit ka dhe duhet të ketë për besimtarin, dhe se si jeta e gjithsecilit duhet të thuret me dantellat e shpalljes duke ngulmuar që përditë të thurë diçka, një pjesë, a sa të mundet, a nëse është e mundur, të ndriçojë botën e brendshme duke e lexuar të gjithin.

Të njëjtat këshilla ne i shohim të jetësuar edhe në fjalët profetike si edhe të zbatuara edhe nga shokët e Resultit të Nderuar (a.s.), e kështu, sahabët u bënë yje të njerëzimit ngaqë mbi ta binte si mëshirë shpallja dhe u rrinte në krye i Dërguari i

1. Kuran, Surja Muzemil, 73:4-5.

2. Kuran, Surja Hixhr, 15:9.

3. Kuran, Surja Fatir, 35:29-30.

Allahut si përcjellës dhe si zbërthyes e mësues i Fjalës së Allahut (xh.sh.).

Le të vështrojmë me kujdes tek disa prej haditheve që na përcillen:

Uthman Ibn Afani (a.s.), transmeton se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Më i miri prej jush është ai që e mëson për vete Kuranin dhe ia mëson atë edhe të tjerëve”. (Buhariu dhe Muslimi)

Aishja (r.a.), gjithashtu transmeton se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Ai që e lexon rrjedhshëm Kuranin është bashkë me melaqet e nderuara, ndërsa ai që e lexon Kuranin me vështirësi, ngaqë nuk i zotëron mirë rregullat, ka dy shpërblime”. (Buhariu dhe Muslimi)

Ebu Dherr El-Gifari (r.a.), transmeton:

“Thashë, o i dërguari Allahut më këshillo? Tha: Të këshilloj ta keshë frikë Allahun se kjo është gjëja kryesorë. Thash: Më shto: Tha: Lexoje shumë Kuranin, sepse ai është nur për ty në tokë, e krenari për ty në qiell”. (Ibn Hibani)

Abdullah Ibn Abasi (r.a.), transmeton se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Ai që nuk ka në zemër asgjë nga Kurani është pors i një shtëpi e shkatërruar”. (Sahih, Tirmidhiu)

Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Ata që e lexojnë Kuranin janë të dashurit e të zgjedhurit e Allahut”. (Nesaiu dhe Ibn Maxhe)

Abdullah Ibn Mesudi (r.a.), transmeton se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Me të vërtetë Kurani është banketi (ku ka mirësi të shumta) i Allahut. Mësoni prej tij sa të mundeni. Me të vërtetë ky Kuran është litari i Allahut i cili është tepër i fortë dhe kurrë nuk këputet, është dritë e qartë, është shërim i dobishëm, është mbrojtje për atë që kapet pas tij, është shpëtim

për atë që e ndjek. Kuranit kurrë nuk i shterojnë misteret e tij, lexojeni sepse Allahu ju shpërblen me mirësi kur e lexon atë me dhjetë sevape për çdo germë.” (Sahih, Hakimi)

Ebu Musa El-Esh'ari, (r.a.), transmeton se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

Shembulli i besimtarit i cili lexon Kuranin është si shembulli i portokallit që ka aromë të mirë dhe shije të këndshme,

Shembulli i besimtarit i cili nuk e lexon Kuranin është si shembulli i hurmës që shijen e ka të mirë por nuk ka aromë,

Shembulli i munafikut që lexon Kuran është si basili që aromën e ka të mirë por shijen e ka të keqe,

Shembulli i munafikut që nuk e lexon Kuranin është si shembulli i Handhales (pemë e egër) që shijen e ka të keqe dhe nuk ka as aromë”. (Buhariu dhe Muslimi)

Ebu Hurejra (r.a.), ka thënë:

“Në atë shtëpi që lexohet Kurani jeta ka gjallëri, shtohet mirësia dhe prezantojnë melaqet dhe largohen shejtanët. Ndërsa në atë shtëpi që nuk lexohet Kurani vështirësohet jeta, pakësohet hajri, largohen melaqet dhe prezantojnë shejtanët”.

Hasani, (r.a.), ka thënë:

“Nuk ka pasuri ai që është larg Kuranit, dhe nuk ka varfëri ai që është i lidhur me Kuranin”.

Ndërsa për ata që e harrojnë Kuranin, Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Ai që e mëson Kuranin pastaj e harron atë, do të vijë Ditën e Gjykimit me duar të prera”. (Ebu Davud)

Dobia e Kuranit për botën tjetër

Ebu Uame El-Bahili transmeton se Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Lexojeni Kuranin, sepse ai do të vijë ndërmjetësues në Ditën e Gjykimit për ata që e kanë lexuar”. (Muslimi)

Muhamedi (a.s.), ka thënë:

“Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë për njeriun Ditën e Gjykimit. Agjërimi do të thotë: O Zot, unë e ndalova atë nga ushqimi e pija gjatë ditës, më ndërmjetëso mua për të. Ndërsa Kurani thotë: O Zot, unë e ndalova nga gjumi natën më ndërmjetëso mua për të, dhe që të dy ndërmjetësojnë”. (Imam Ahmed)

Ebu Uame tregon se Muhamedi (a.s.) na ka nxitur në mësimin e Kuranit, pastaj na ka folur për vlerat e tij e ka thënë:

“Kurani do të vijë Ditën e Gjykimit tek ai që e ka lexuar atëherë kur ka më së shumti nevojë. Do t'i vijë atij me pamjen më të bukur dhe do t'i thotë: “A më njeh mua? Ai i thotë: “Kush je ti? I thotë: “Unë jam ai që ti e doje, e nderoje, rrije zgjuar me mua,

e gjallëroje ditën me mua. Ai thotë: “Ndoshta ti je Kurani” Pastaj paraqitet para Allahut të Madhëruar, i Cili i jep mbretërinë nga e djathta, përjetësinë nga e majta, i vendoset kurora e mbretërisë mbi kokë, dhe prindërit e tij musliman veshin rroba tepër të bukura dhe thonë: “Prej nga i kemi këto të mira ndërkohë që ne nuk i kemi bërë me punët tona? I thuhet: “Për shkak të djalit tuaj i cili ka lexuar Kuranin dhe juve ju është dhënë kjo”.

Abdullah Ibn Mesudi (r.a.) ka thënë:

“Kurani është ndërmjetësuesi që ndërmjetëson, dhe e vërteta që të pastron. Kush e merr si prijësin e vet duke e lexuar e praktikuar do ta udhëzojë drejt e në Xhenet, dhe kush e len pas shpine duke mos e lexuar dhe mos punuar me të do ta shtyjë drejt e në Xhehenem”.

Abdullah Ibn Amër Ibn Asi (a.s.), transmeton nga Muhamdi (a.s.), se ka thënë:

“I thuhet lexuesit të Kuranit, lexo dhe ngritu, lexo siç lexoje edhe në dynja sepse grada jote do të jetë deri në ajetin e fundit që do të lexosh”. (Sahih, Tirmidhiu dhe Nesaiu)

Si e lexuan Kuranin Sahabët, shokët e Muhamedit (a.s.)?

Allahu xh.sh për vlerën e Sahabëve thotë:

“Ju jeni ymeti (populli) më i mirë se të tjerët që janë paraqitur ndonjëherë. Urdhëroni për të mirë dhe ndaloni nga e keqja, dhe të besoni në Allahun. ...”⁴

Sahabët e lexonin Kuranin shumë sa që kanë thënë:

“E mësonim imanin (besimin), para se ta mësonim Kuranin, e kur e mësonim Kuranin, na u shtonte imani”.

Ibn Ebu Davud transmeton për sahabët se disa prej tyre e bënë Kuranin hatme (e lexonin nga fillimi deri në fund):

- 1.) Në çdo dy muaj,
- 2.) Disa të tjerë në çdo muaj,
- 3.) Disa të tjerë në çdo 10 (dhjetë) ditë,
- 4.) Disa të tjerë në çdo 8 (tetë) ditë,
- 5.) Disa të tjerë në çdo 7 (shtatë) ditë,
- 6.) Disa të tjerë në çdo 6 (gjashtë) ditë,
- 7.) Disa të tjerë në çdo 5 (pesë) ditë,
- 8.) Disa të tjerë në çdo 4 (katër) ditë,
- 9.) Disa të tjerë në çdo 3 (tri) ditë,
- 10.) Disa të tjerë në çdo 2 (dy) ditë,
- 11.) Disa të tjerë në çdo 1 (një) ditë,
- 12.) Disa të tjerë një hatme natën, një hatme ditën,
- 13.) Disa të tjerë 3 (tri) hatme, për një natë dhe një ditë,
- 14.) E disa të tjerë bënë 8 (tetë) hatme, 4 (katër) natën dhe 4 (katër) ditën.

4. Kuran, Surja Ali Imran, 3:110.



Tradita që bashkon, besimi që frymëzon, kultura që ndërton të ardhmen

Tema e këtij simpoziumi - "Tradita që bashkon, besimi që frymëzon, kultura që ndërton të ardhmen"¹ - është më shumë se një titull i bukur. Ajo përmbledh një të vërtetë që shoqëria shqiptare e ka dëshmuar ndër breza: se besimi, kur kuptohet në thelbin e tij, nuk ndërton mure mes njerëzve, por ura; nuk ushqen përçarjen, por respektin; nuk e mbyll njeriun në vetvete, por e fton atë të shohë tjetrin me dinjitet dhe mirësi.

Shqipëria është një vend i vogël në hartë, por një vend me një përvojë të jashtëzakonshme njerëzore. Këtu, dallimet fetare nuk janë shndërruar në arsye për të mohuar njëri-tjetrin.

1. Fjala e Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, në Konferencën Jubilare të organizuar nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me temë: "Tradita që bashkon, besimi që frymëzon, kultura që ndërton të ardhmen".

Përkundrazi, në momente të rëndësishme të historisë sonë, shqiptaria ka ditur të krijojë një hapësirë ku myslimani, bektashiu, katoliku, ortodoksi, ungjillori dhe çdo qytetar tjetër mund të ndihen pjesë e së njëjtës familje shoqërore.

Por kjo nuk është një pasuri që duhet ta marrim si të mirëqenë.

Harmonia ndërfaqetare është një amanet.

Dhe çdo brez ka detyrimin ta ruajë, ta forcojë dhe t'ua përcjellë brezave që vijnë.

Në një kohë kur bota përballet me konflikte, polarizim, gjuhë urrejtjeje dhe përpjekje për ta shndërruar dallimin në armiqësi, përvoja shqiptare merr një rëndësi të veçantë. Ajo na kujton se identitetet mund të bashkëjetojnë pa e humbur veçantinë e tyre dhe

se respekti për tjetrin nuk e dobëson identitetin tënd; përkundrazi, e fisnikëron atë.

Besimi fetar, në thelbin e tij, e ngre njeriun mbi egoizmin, mbi urrejtjen dhe mbi tundimin për ta parë tjetrin si kundërshtar.

Në traditën islame, njeriu është bartës i dinjitetit dhe përgjegjësisë. Besimi nuk është vetëm marrëdhënie personale me Zotin; ai shfaqet edhe në mënyrën se si sillemi me tjetrin, si e trajtojmë të ndryshmin, si e mbrojmë të dobëtën dhe si kontribuojmë për të mirën e përbashkët.

Prandaj, dialogu ndër fetar nuk duhet të jetë vetëm një takim protokollar i institucioneve fetare. Ai duhet të jetë kulturë shoqërore.

Duhet të jetë mënyra se si edukojmë fëmijët tanë.

Duhet të jetë mënyra se si flasim për njëri-tjetrin.

Duhet të jetë mënyra se si reagojmë përballë padrejtësisë dhe urrejtjes.

Dhe mbi të gjitha, duhet të jetë mënyra se si e kuptojmë se mund të kemi bindje të ndryshme, por të ndajmë të njëjtin dinjitet njerëzor dhe të njëjten përgjegjësi për vendin ku jetojmë.

Kjo është një nga vlerat më të çmuara të Shqipërisë.

Dhe këtu dua të vlerësoj veçanërisht rolin që komunitetet fetare kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë në ruajtjen e kësaj klime mirëkuptimi.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane kanë historitë, traditat dhe institucionet e tyre vëllazërore. Por ajo që na bashkon është shumë më e madhe se ajo që na dallon: besimi te Zoti, respekti për njeriun, dashuria për atdheun dhe bindja se paqja është një vlerë që duhet ndërtuar çdo ditë.

Prandaj, harmonia nuk do të thotë mungesë dallimesh.

Harmonia do të thotë të dish të jetosh me dallimet pa i shndërruar ato në konflikt.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron një nga mësimet më të bukura që Shqipëria mund t'i japë botës.

Ne nuk duhet t'i themi botës se shqiptarët nuk kanë dallime.

Duhet t'i tregojmë se shqiptarët kanë ditur t'i kthejnë dallimet në bashkëjetesë.

Të nderuar të pranishëm,

Sot nderojmë edhe historinë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane. 35 vite nga rihapja e saj, 15 vite udhëheqja e Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj dhe 11 vite nga inaugurimi i këtij kompleksi janë momente që meritojnë të kujtohen me respekt.

Por jubileu nuk është vetëm një kthim pas.

Jubileu është edhe një pyetje për të ardhmen.

Çfarë do t'u lëmë brezave që vijnë?

A do t'u lëmë vetëm ndërtesa, libra, institucione dhe kujtime?

Apo do t'u lëmë një kulturë të bashkëjetesës, një

shoqëri ku besimi të jetë burim paqeje dhe ku dallimi të jetë pasuri?

Unë besoj se përgjigjja duhet të jetë kjo e dyta.

Sepse trashëgimia më e madhe e një institucioni fetar nuk është vetëm ajo që ka ruajtur nga e kaluara, por edhe ajo që arrin të mbjellë për të ardhmen.

Në këtë kuptim, tradita nuk duhet të jetë një muze i së shkuarës.

Tradita duhet të jetë një forcë që i jep kuptim së ardhmes.

Dhe besimi, nëse është i gjallë, nuk na largon nga shoqëria. Na bën më të përgjegjshëm ndaj saj.

Na kërkon të jemi më të drejtë, më të mëshirshëm, më të ndershëm dhe më të dobishëm për njerëzit që na rrethojnë.

Në emër të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dua të shpreh bindjen se bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve fetare shqiptare nuk është vetëm një traditë e bukur që duhet ruajtur; është një nevojë e së tashmes dhe një investim për të ardhmen.

Nëse duam një shoqëri më të qetë, më të drejtë dhe më njerëzore, duhet të punojmë së bashku.

Duhet të flasim më shumë me njëri-tjetrin dhe më pak për njëri-tjetrin.

Duhet të gjejmë atë që na bashkon pa e mohuar atë që na dallon.

Dhe duhet t'u a mësojmë brezave të rinj se të respektosh tjetrin nuk do të thotë të heqësh dorë nga vetja.

Përkundrazi, njeriu që është i sigurt në identitetin e tij nuk ka frikë nga ndryshimi dhe nuk ka nevojë ta poshtërojë tjetrin për të afirmuar veten.

Të nderuar miq,

Në emër të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ju përcjell urimet më të përzemërta për këtë jubile dhe për këtë veprimtari me rëndësi.

Uroj që Kryegjyshata Botërore Bektashiane të vazhdojë të jetë një institucion i dialogut, i paqes dhe i kulturës; një vend ku tradita ruhet me dinjitet, por njëkohësisht i flet edhe kohës sonë.

Dhe uroj që Shqipëria të vazhdojë ta ruajë atë që është ndoshta një prej pasurive të saj më të çmuara: aftësinë për të qenë bashkë, duke qenë të ndryshëm.

Sepse në fund të fundit, paqja nuk ndërtohet kur të gjithë mendojnë njësoj.

Paqja ndërtohet kur njerëzit, edhe kur mendojnë ndryshe, zgjedhin të respektojnë njëri-tjetrin.

Tradita na mëson se kush jemi. Besimi na kujton se për çfarë jetojmë. Dhe kultura na mëson se si ta ndërtojmë së bashku të nesërmen.

Le të vazhdojmë ta ndërtojmë atë të nesërme me mirëkuptim, me respekt dhe me besim te njëri-tjetri. Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe të gjithë njerëzit e saj!

01 KRYETARI SPAHIU PRET NË KMSH ZYRTARË TË AMBASADËS SË SHBA-SË NË TIRANË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahi, priti në një takim kortezie Znj. Olivia Maigret, zyrtare për Çështjet Politike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetari Spahi uroi mirëseardhjen ai vlerësoi marrëdhëniet e mira dypalëshe mes Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së SHBA-ve.

Ai gjithashtu e njohu znj. Maigret me historinë, organizimin, institucionet arsimore, misionin e institucionit, si dhe rolin e tij në ruajtjen e harmonisë dhe dialogut ndërfetar në Shqipëri.

Nga ana e saj, znj. Maigret shprehu kënaqësinë për këtë takim dhe vlerësoi rolin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në shoqëri si dhe angazhimin e tij në promovimin e vlerave të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare.

Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe bashkëpunuese, ku u diskutua mbi tematika të ndryshme të karakterit fetar, social e kulturor që prekin aktualitetin e vendit tonë, duke shërbyer si një mundësi e mirë për të forcuar më tej marrëdhëniet mes dy institucioneve.



02 INAUGUROHET XHAMIA E RE E LAGJES TOPHANË NË QYTETIN E SHKODRËS



Ditën e djeshme, hapi dyert për të gjithë besimtarët e qytetit dhe jo vetëm, xhamia më e re e Shkodrës, xhami e cila u ndërtua nga "Qatar Charity", një event i shumëpritur për të gjithë besimtarët e këtij qyteti.

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Drejtori i "Qatar Charity", z. Kerem Ali, Myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, si dhe hoxhallarë të shumtë të qytetit, drejtues institucionesh të ndryshme, banorë të lagjes Tophanë, si dhe besimtarë të shumtë të Shkodrës.

Aktiviteti filloi me prerjen simbolike të shiritit të inaugurimit të xhamisë nga të lartpërmendurit, për të vijuar me një program të shkurtër në ambientet e saj.

Programi u çel me leximin e disa ajeteve kuranore nga teologu Gëzim Dungaj.

Më pas, të pranishmit i përshëndeti Myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, i cili u uroi mirëseardhjen besimtarëve të pranishëm në këtë eveniment kaq të shumëpritur për të gjithë. Po ashtu, ai shprehu falënderimet e tij për këtë bashkëpunim të frytshëm me "Qatar Charity", për ndërtimin e xhamisë së Tophanës, një xhami me domethënie të veçantë për këtë lagje, e ndërtuar fillimisht 421 vite më parë në të njëjtin vend nga bamirësi Mustafa Efendiu, hatib i xhamisë së Tophanës.

Ceremonia vijoi me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili u ndal te roli dhe rëndësia e xhamive në edukimin dhe formimin e brezave të rinj. Ai theksoi se xhamia nuk është vetëm një hapësirë adhurimi, por edhe një vatër e rëndësishme edukimi, dijeje dhe kultivimi të vlerave, duke kontribuar në formimin e individëve me karakter të shëndoshë, të përgjegjshëm dhe të dobishëm për familjen dhe shoqërinë.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu shprehu gjithashtu mirënjohjen për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe kontributin e çmuar të "Qatar Charity", duke vlerësuar mbështetjen e tyre në projekte dhe iniciativa që i shërbejnë anë e mbanë vendit tonë.

Më tej, z. Kerem Ali, drejtor i "Qatar Charity", shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimin me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe Myftininë Shkodër, për realizimin e këtij projekti të domosdoshëm për qytetin e Shkodrës dhe ftoi besimtarët ta mirëmbajnë e ta frekuentojnë sa më shumë atë. Në përfundim të aktivitetit, Kryetari Spahiu mbajti hutben e xhumasë së parë në këtë xhami.



03 "TRËNDAFILI I MEDINËS" – AKTIVITETI NË PËRKUJTIM TË JETËS DHE VEPRËS SË PROFETIT MUHAMED ﷺ



Në Sallën e Konferencave të Qendrës Tregtare Blustar në Durrës u zhvillua aktiviteti me titull "Trëndafili i Medinës", organizuar nga Myftinia Durrës, në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, në një atmosferë të ngrohtë kushtuar jetës, veprës dhe mesazhit që përcolli Profeti ynë i dashur, Muhamedi ﷺ.

Në këtë takim ishin të pranishëm Myftiu i Durrësit, z. Eduard Shefkiu, Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, imami i Xhamisë së Qendrës, z. Ervin Qylafku, hoxhallarë, besimtarë dhe qytetarë të shumtë të qytetit bregdetar.

Aktiviteti u çel me leximin e disa ajeteve Kuranore, për të vijuar me transmetimin e një dokumentari të shkurtër mbi të Dërguarin e Allahut (xh.sh).

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Durrësit, z. Shefkiu, u ndal te rëndësia e njohjes së jetës dhe shembullit të Profetit Muhamed ﷺ, duke theksuar veçanërisht domosdoshmërinë e ndjekjes së Sunetit të tij si udhërrëfim për jetën e besimtarit dhe si rrugë drejt një marrëdhënieje më të fortë me Allahun (xh.sh.) e rrjedhimisht, fitimit të kënaqësisë së Tij, si në këtë botë, po ashtu edhe në Ahiret.

Më tej, Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, trajtoi ndikimin e jashtëzakonshëm që solli ardhja e Profetit Muhamed ﷺ në këtë botë, duke u ndalur te ndryshimet që ai solli në shoqërinë e asaj kohe dhe jehona e këtij mesazhi në ditët e sotme.

Aktiviteti u përmbyll me referimin e imamit të Xhamisë së Qendrës së Durrësit, z. Ervin Qylafku, i cili u ndal në veçoritë e larta morale të Profetit Muhamed ﷺ dhe në detyrën që ka secili prej nesh për ta njohur, dashur dhe ndjekur shembullin e tij.



04 PËRMBYLLET ME SUKSES FUSHATA “PAQE DHE HARMONI”



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në aktivitetin përmbyllës të fushatës “Paqe dhe Harmoni”, të zhvilluar në Tiranë në kuadër të projektit “Shpërndarje mesazhesh nga udhëheqësit fetarë dhe të komunitetit në Shqipëri”.

Aktiviteti mbledhi përfaqësues të institucioneve shtetërore, Bashkimit Evropian, komuniteteve fetare dhe partnerëve të projektit, ndërsa në fokus ishte prezantimi i rezultateve dhe ndikimit të fushatës, si dhe rëndësia e komunikimit strategjik në promovimin e paqes, harmonisë dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu u ndal në rëndësinë e ruajtjes dhe forcimit të traditës shqiptare të bashkëjetesës fetare, duke theksuar se ajo përbën jo vetëm një trashëgimi të çmuar, por edhe një përgjegjësi që duhet mbrojtur dhe përcjellë te brezat e rinj.

Ai nënvizoi se parandalimi i ekstremizmit kërkon një qasje të gjerë, të mbështetur në edukim, familje të forta, komunitete mbështetëse dhe përfshirjen e të rinjve në jetën shoqërore. Gjithashtu, ai vlerësoi rolin e institucioneve fetare në promovimin e paqes, drejtësisë, mëshirës dhe dinjitetit njerëzor.

Në fjalën e saj, Drejtoresha e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, znj. Lejdi Dervishi, vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të komunikimit në forcimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë. Përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe institucioneve të tjera të pranishme përshëndetën aktivitetin dhe përcollën mesazhet e tyre mbi rëndësinë e bashkëjetesës, respektit të ndërsjellë, forcimit të kohezionit social dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.



05 FILLON VITI I RI SHKOLLOR 2026-2027 NË MBARË VENDIN TONË



Sot nis një tjetër rrugëtim i bukur drejt dijes në Medresenë e Tiranës dhe mbarë shkollat e tjera të vendit tonë.

Me këtë rast, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ishte i pranishëm në ceremoninë e çeljes së vitit të ri shkollor në Medresenë e Tiranës, së bashku me Drejtorin e Arsimit në KMSH, z. Surja Shehi, Drejtorin e Medresesë, z. Ardit Dragoti, stafin pedagogjik, nxënësit dhe familjarët e tyre.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu përcolli një urim të veçantë për nxënësit e Medresesë, duke i nxitur që dijen ta shoqërojnë gjithmonë me përkushtim, edukatë të mirë dhe përgjegjësi, ndërsa mësuesve u shprehu mirënjohjen për misionin e tyre në edukimin dhe formimin e brezit të ri.

“Të dashur nxënës, përkushtojuni dijes, kultivoni edukatën dhe mos reshtni së ëndërruari e së punuari për të ardhmen tuaj. Besoj se me punë, vullnet dhe mbështetjen e mësuesve e familjeve tuaja, çdo sfidë do të shndërrohet në një mundësi për t’u rritur dhe për të arritur më shumë. Suksesi juaj është gëzim për familjet tuaja dhe një kontribut i çmuar për të ardhmen e vendit tonë!” – u shpreh ai.

Në fjalën e tij, Drejtori i Arsimit pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Shehi, theksoi rëndësinë e dijes dhe edukimit në formimin e brezit të ri, duke u ndalur te vlerat islame që duhet ta shoqërojnë këtë proces.

Ndërsa, Drejtori i Medresesë, z. Dragoti, i inkurajoi nxënësit që të synojnë lart, të punojnë me përkushtim dhe të mos u druhen sfidave, duke e shoqëruar dijen me karakter, modesti, respekt dhe integritet.

Më tej, nxënësit u shpërndanë nëpër klasa, duke nisur orët e para të mësimin dhe duke filluar kështu ditën e parë të një tjetër viti shkollor në rrugëtimin e tyre të bukur drejt dijes.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ju uron suksese të gjithë nxënësve në vitin e ri shkollor 2026–2027!



06 MYFTINIA DIBËR ZHVILLOI SIMPOZIUMIN “TË NJIHEMI ME PROFETIN MUHAMED ﷺ”



Myftinia Dibër, zhvilloi në Pallatin e Kulturës në qytetin e Peshkopisë simpoziumin me temë “Të njihemi me Profetin Muhamed ﷺ”, një aktivitet kushtuar njohjes së jetës, misionit dhe virtyteve të larta të të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryetari i Bashkisë Peshkopi, z. Rahim Spahiu, Myftiu i Dibrës, z. Muis Kurtulla, Drejtori i Arsimit në KMSH, z. Surja Shehi, Myftiu i Bulqizës, z. Sejdin Strazimiri, Myftiu i Matit, z. Hysni Skura, si dhe imamë, hoxhallarë e besimtarë të shumtë.

Programi u çel me leximin e disa ajeteve nga Kurani Famëlartë, për të vijuar me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Dibrës, z. Muis Kurtulla. Në fjalën e tij, ai falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe vuri në pah rëndësinë e njohjes së jetës dhe shembullit të Profetit Muhamed ﷺ, duke u ndalur te morali i lartë, sakrifica, mëshira dhe solidariteti që ai përcolli për mbarë njerëzimin.

Të pranishmit u përshëndetën gjithashtu nga Kryetari i Bashkisë Peshkopi, z. Rahim Spahiu, i cili vlerësoi rëndësinë e këtij aktiviteti dhe mesazhet e paqes, mirësisë, tolerancës, solidaritetit dhe respektit që përcjell tek pjesa tjetër e komunitetit.

Në vijim, fjalën e mori Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, i cili solli në vëmendje momente dhe dimensione të rëndësishme nga jeta e Profetit Muhamed ﷺ. Programi vijoi me referimin e imamet të Xhamisë “Tufinë”, z. Nasuf Hoxha, i cili u ndal te rëndësia e njohjes dhe përvetësimit të shembullit profetik në shoqërinë e ditëve të sotme.



Falja e gabimeve dhe MOSNDJEKJA E TË PADITURVE

"Merr faljen, urdhëro për të mirën dhe largohu nga të paditurit. (Kuran, Surja El-A'raf, 7:199)

Allahu i Madhëruar, duke mos dashur t'i ngarkojë robërit e Tij me gjëra të rënda, në këtë ajet i drejtohet Profetit ﷺ me tri porosi të mëdha:

Së pari: Të jetë i butë dhe tolerant në marrëdhëniet me njerëzit, duke i falur gabimet e tyre dhe duke mos ua vështirësuar jetën. Pra, të mos i shikojë njerëzit me ashpërsi për gabimet e tyre, por t'i mbulojë dhe t'i trajtojë me mëshirë.

Së dyti: Të urdhërojë njerëzit për atë që është e drejtë, e bukur dhe e pranuar nga mendja e shëndoshë dhe feja; dhe kur ta bëjë këtë, ta bëjë me një mënyrë të butë dhe të urtë, në mënyrë që njerëzit ta pranojnë me dëshirë dhe dashuri.

Së treti: Të mos u kushtojë vëmendje të paditurve, atyre që nuk e njohin Zotin dhe që sillen në mënyrë të vrazhdë e të pahijshme, por të mos u përgjigjet me të njëjtën sjellje dhe të mos zbresë në nivelin e tyre.

Në një transmetim të njohur, një beduin i ashpër i quajtur Ujejne bin Hisn shkoi tek kushëri i tij Hurr bin Kajs, i cili ishte nga njerëzit që Omeri (r.a) e respektonte dhe merrte mendimin e tij.

Ujejne i tha atij: "O nipi im! Ti ke pozitë të lartë tek halifi. Kërko leje që ta vizitohet."

Ai mori leje dhe shkuan tek Omeri (r.a). Kur hynë, Ujejne i tha halifit: "O Omer! Nuk na jep pasuri të mjaftueshme dhe as nuk gjykon me drejtësi midis nesh!"

Omeri u zemërua shumë dhe u ngrit drejt tij. Por Hurr bin Kajs ndërhyri menjëherë dhe tha: "O Prijës i Besimtarëve! Allahu i Madhëruar i ka thënë Profetit të Tij: 'Merr faljen, urdhëro për të mirën dhe largoj të paditurve.' Ky njeri është prej të paditurve."

Kur e dëgjoi këtë, halifi i madh u ndal menjëherë dhe nuk bëri asnjë hap më tej. Rivajeti tregon se ai qëndroi i palëvizur, si i ngrirë në vend, dhe nuk reagoi më me zemërim.

Në fakt, veprat më të larta të moralit janë: të shkosh tek ai që nuk vjen tek ti, të japësh atij që nuk të jep dhe të falësh atë që të ka bërë padrejtësi. Prandaj, të mos u bindesh të paditurve dhe të mos zbresësh në nivelin e tyre është sjellja më e mirë dhe më fisnike. **"Prandaj falje të bukur (tregoji durim të madh dhe mos u hakmerr)."** – (Kuran, Surja El-Hixhr, 15:85)

Kjo urdhëresë vjen në vazhdim me kuptime të tjera të ngjashme, duke theksuar durimin dhe faljen e bukur ndaj njerëzve. **"Le të falin dhe le të mos ua marrin për të keq. A nuk dëshironi që Allahu t'ju falë juve?"** – (Kuran, Surja En-Nur, 24:22)

Njeriu zakonisht nuk dëshiron t'i falë gabimet që bëhen kundrejt tij. Sepse, para së gjithash, nefsi (egoja) e kundërshton këtë dhe e shndërron faljen e fajtorit në çështje krenarie. Për këtë arsye, falja e gabimeve është konsideruar në fenë tonë një virtut i madh.

Ebu Bekri (r.a.) ka një shembull shumë të qartë në këtë çështje, ashtu si në shumë të tjera.

Në historinë Islame ekziston ngjarja e njohur si "Hadithi i Ifkut" (akuzës së rreme). Kur Profeti ﷺ shkoi në një ekspeditë, mori me vete bashkëshorten e tij Aishe bint Ebu Bekr. Gjatë kthimit, ajo u largua për nevojë personale nga vendi ku ndodhej ushtria. Në këtë kohë i humbi gjerdani dhe filloi ta kërkonte, duke humbur pak kohë. Ndërkohë, myslimanët menduan se ajo ishte në pajisjen e saj (hevdexh) dhe u nisën për rrugë.

Kur Aishe bint Ebu Bekr u kthye në vendin e pushimit, pa se ushtria kishte ikur. Ajo mbeti aty duke pritur. Më vonë, një sahabi që ishte në preparojë e gjeti dhe e çoi me devenë e tij te Profeti ﷺ. Fatkeqësisht, kjo ngjarje u bë shkak për thashetheme. Disa hipokritë e shfrytëzuan këtë rast për të shpifur kundër saj. Me këtë shpifje u lënduan si Nëna e Besimtarëve, familja e saj dhe vetë i Dërguari i Allahut ﷺ.

Por Allahu i Madhëruar e shpalli pafajësinë e saj me shpallje hyjnore dhe e pastroi nga çdo akuzë. Profeti ﷺ gjithashtu ndëshkoi shpifësit.

Njëri prej tyre ishte edhe Mistah ibn Ethatha, i cili ishte i afërm i Ebu Bekri dhe që ai e mbante dhe e ndihmonte. Kur ndodhi kjo, Ebu Bekri u mërzi shumë dhe u betua se nuk do ta ndihmonte më Mistahun. Atëherë zbriti ajeti: **"Le të mos betohen njerëzit me pasuri dhe mirësi se nuk do t'u japin të afërmeve dhe të varfërve; le t'i falin dhe të mos i marrin për keq. A nuk dëshironi që Allahu t'ju falë juve?"** – (Kuran, Surja En-Nur, 24:22)

Kur Ebu Bekri e dëgjoi këtë ajet, tha:

"Po, o Zoti ynë! Pasha Allahun, ne dëshirojmë që Ti të na falësh." Dhe menjëherë ai vazhdoi ta ndihmonte Mistahun si më parë. Allahu na dhëntë edhe neve bindjen dhe dorëzimin e Ebu Bekri. Amin. **"Ata i falin njerëzit. Allahu i do bamirësit."** – (Kurani, Surja Ali Imran, 3:134)

Në këto ajete, falja e gabimeve dhe të metave të të tjerëve rekomandohet fuqimisht. Falja me qëllim fitimin e kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut është një virtut shumë i madh. Të durosh sjelljet e ashpra dhe të falësh gabimet është një moral i lartë që mund ta praktikojnë vetëm njerëzit me karakter të lartë.

Duhet të theksojmë se falja ka të bëjë me gabimet personale që bëhen ndaj individit. Por nëse një gabim prek shoqërinë, atëherë çështja nuk është thjesht falje, por

drejtësi dhe vendosje e së vërtetës. Sepse askush nuk ka të drejtë të falë padrejtësi që dëmtojnë shoqërinë. Falja në raste të tilla do të çonte në padrejtësi më të mëdha.

"Kush duron dhe fal, kjo është prej vendimeve më të larta dhe më të forta." – (Kuran, Surja Esh-Shura, 42:43)

T'i përgjigjesh të keqes me të keqe është një e drejtë e lejuar. Allahu ia ka dhënë njeriut këtë të drejtë, prandaj ai që merr hakun e vet nuk fajësohet.

Por nga një këndvështrim tjetër, hakmarrja është diçka që mund ta bëjë kushdo, ndërsa durimi dhe falja janë veprime të njerëzve të mëdhenj. Njerëzit me shpirt të lartë e mposhtin nefsën dhe zgjedhin faljen në vend të hakmarrjes.

Profeti ﷺ nuk është hakmarrë për veten e tij ndaj askujt. Njerëzit e mëdhenj gjejnë kënaqësi në mposhtjen e egos dhe në fitimin e kënaqësisë së Allahut duke falur të tjerët në vend që të marrin hak.

Transmetohet nga Aishe bint Ebu Bekr se një ditë e pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ:

"A ke përjetuar ndonjë ditë më të vështirë se dita e Uhudit?"

I Dërguari i Allahut ﷺ u përgjigj: *"Po. Nga populli yt kam përjetuar shumë vuajtje. Më e rënda prej tyre ishte ajo që më ndodhi në ditën e Akabes. Atë ditë shkova te Ibn Abdijalil, nga të parët e Taifit, duke kërkuar mbrojtje, por ai nuk më pranoi. U ktheva i trishtuar dhe ecja i mbushur me pikëllim, derisa arrita në vendin e quajtur Karnuth-Tha'lib. Atje ngrita kokën dhe pashë një re që më bënte hije. Kur vështrova me vëmendje, pashë brenda resë Xhibrilin ﷺ. Ai më tha: 'Allahu i Madhëruar e ka dëgjuar atë që populli yt të tha dhe refuzimin e tyre për të të mbrojtur. Ai ka dërguar te ti Engjëllin e Maleve për të zbatuar atë që ti dëshiron.'"*

Pastaj Engjëlli i Maleve më përshëndeti dhe tha: *"O Muhamed! Allahu e ka dëgjuar atë që të ka thënë populli yt. Unë jam Engjëlli i Maleve. Zoti më ka dërguar tek ti që të zbatoj çdo urdhër tëndin. Çfarë dëshiron? Nëse dëshiron, i bashkoj këto dy male mbi ta."*

Unë thashë: *"Jo. Unë shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre njerëz që do ta adhurojnë vetëm Allahun dhe nuk do t'i bëjnë Atij shok."* – Sahih Buhari; Sahih Muslim.

Në luftën e Uhudit, i Dërguari i Allahut ﷺ kaloi sprovën të rënda. Idhujtarët iu afruan shumë dhe disa sahabë e mbrojtën me trupat e tyre. Megjithatë, një shigjetë e goditi fytyrën e tij të bekuar dhe ai u plagos; iu thye edhe një dhëmb.

Pikërisht për këtë, Aishe bint Ebu Bekr e pyeti nëse kishte përjetuar ditë më të vështirë se ajo e Uhudit. Profeti ﷺ u përgjigj duke përmendur vuajtjet e tij në Taif, një ngjarje shumë e dhimbshme në historinë Islame, kur ai u refuzua dhe u lëndua nga banorët e atij qyteti, megjithëse kishte shkuar tek ata për t'i thirrur në Islam.

Megjithatë, kulmi i këtij tregimi është mëshira e jashtëzakonshme e Profetit ﷺ. Edhe kur iu ofrua mundësia për t'i shkatërruar ata, ai nuk kërkoi hakmarrje, por shpresoi që nga pasardhësit e tyre të dalin njerëz që do ta adhurojnë

Allahun Një. Kjo është një nga shembujt më të lartë të durimit, mëshirës dhe moralit profetik.

I Dërguari i Allahut ﷺ, pasi humbi bashkëshorten e tij besnike dhe burim ngushëllimi Hatixhe bint Huvejlid, dhe më pas edhe xhaxhain e tij që e mbronte nga idhujtarët, Ebu Talib ibn Abdulmuttalibin, u përball me një periudhë shumë të vështirë që u quajt "viti i pikëllimit".

Pas kësaj kohe, urrejtja dhe dhuna e idhujtarëve të Mekës u shtua edhe më shumë. Për shkak se nuk kishte më askënd që ta mbronte në Mekë, Profeti ﷺ vendosi të shkonte në Taif për t'u thirrur banorëve të tij në Islam. Ai shpresonte që nëse disa prej të parëve të atij qyteti do të pranonin Islamin, do të gjente aty një strehë të re për fenë.

Ai mori me vete shërbëtorin dhe të birësuarin e tij Zejd ibn Harithe dhe shkoi në Taif. Për dhjetë ditë ai u shpjegoi atyre Islamin. Por kur iu drejtua njërit prej prijësve më me ndikim, Ibn Abdijalil, ai e refuzoi.

Kjo situatë e trishtoi shumë Profetin ﷺ, si për Islamin ashtu edhe për muslimanët. Jo vetëm që banorët e Taifit e refuzuan, por disa njerëz të thjeshtë u nxitën kundër tij dhe e ndoqën. Në vendin e quajtur Akabe në Taif, ata e goditën me gurë të Dërguarin e Allahut ﷺ, derisa e nxorën nga qyteti. Gurët i shkaktuan plagë në këmbët e tij të bekuara dhe ato filluan të rrjedhin gjak.

Në atë moment, Profeti ﷺ u mbush me pikëllim të thellë. Nuk ishte vetëm trupi i tij i plagosur, por edhe zemra e tij ishte e lënduar. Ai mendonte se kush do t'i mbështeste besimtarët pas kësaj.

I lodhur dhe i trishtuar, ai vazhdoi rrugën derisa arriti në një vend mes Mekës dhe Taifit të quajtur Karnuth-Tha'lib. Atje ngriti kokën dhe pa një re që i bënte hije. Në atë re pa Xhibrilin (a.s.), dhe më pas u takua me Engjëllin e Maleve.

Engjëlli i Maleve i tha se Allahu e kishte dëgjuar çfarë i kishin thënë njerëzit e Taifit dhe i ofroi një mundësi: nëse dëshironte, mund t'i shkatërronte duke bashkuar dy malet mbi ta.

Por Profeti ﷺ, megjithëse i lënduar dhe i përgjakur, nuk e pranoi këtë ofertë. Ai tha se nuk dëshironte që ata të shkatërroheshin, sepse shpresa e tij ishte që nga pasardhësit e tyre të dalin njerëz që do të adhurojnë vetëm Allahun dhe nuk do t'i bëjnë Atij shok.

Kështu, ai tregoi se nuk vepronte për hakmarrje personale, por për të udhëzuar njerëzit dhe për të shtuar ata që e njohin Allahun dhe i nënshtrohen Atij.

Përfundimi i ngjarjes

Më vonë, efektet e kësaj lutjeje u panë. Në vitin e nëntë të hixhretit, banorët e Taifit, duke parë përhapjen e Islamit në të gjithë Arabinë, dërguan një delegacion në Medinë për të pranuar Islamin.

Profeti ﷺ i priti me mirësi dhe i nderoi në xhaminë e tij.

Ata kërkuan disa kushte për pranimin e Islamit, si përjashtim nga namazi dhe lejimin e disa ndalesave, por asnjë prej tyre nuk u pranua. Kur panë se nuk kishte kompromis në parimet e Islamit, ata e pranuan fenë Islame.

Dhurimi i qumështit të gjirit në Islam



Çështja e dhurimit të qumështit të gjirit është bërë objekt diskutimi të shtuar në kohët moderne, sidomos me shfaqjen e bankave të qumështit dhe praktikave të reja mjekësore që nuk kanë qenë të njohura në të kaluarën. Në Islam, kjo temë nuk trajtohet vetëm si çështje ushqimi apo kujdesi shëndetësor, por lidhet drejtpërdrejt me dispozita të rëndësishme juridiko-fetare, pasi gjidhënia mund të krijojë farefisni të posaçme dhe, rrjedhimisht, ndalime martesore. Për këtë arsye, juristët klasikë dhe bashkëkohorë e kanë trajtuar këtë temë me kujdes të veçantë, duke shqyrtuar bazat kuranore e profetike, qëndrimet e medhhebeve, mënyrat e vërtetimit të gjidhënies dhe sfidat moderne që sjellin bankat e qumështit. Ky shkrim synon të paraqesë një përmbledhje të këtyre qasjeve dhe implikimeve praktike të tyre.

1. Përkufizimi i gjidhënies (rada')

Gjidhënie (ar. الرضاعة / الرضاع) do të thotë, që qumështi i një gruaje të konsumohet drejtpërsëdrejti përmes gjidhënies ose në një mënyrë tjetër. Fëmijët ushqehen me qumështin e gjirit të nënës biologjike, por ndodh edhe që të ushqehen nga nëna të tjera. Dhurimi i qumështit të gjirit është një çështje me rëndësi të dyfishtë. Nga njëra anë ka ndikim mjekësor e shoqëror dhe nga ana tjetër ka pasojë juridiko-fetare të rëndësishme lidhur me ndalimin martesor (hurmetin) e gjidhënies. Jurisprudenca islame e trajton këtë çështje gjerësisht, sepse qumështi i gjirit nuk është thjesht një substancë ushqimore, por ai krijon lidhje farefisnore të njohura nga sheriat, mes gruas gjidhënëse, të afërmeve të saj dhe fëmijës.

Pas ushqyerjes me gj, për nga aspekti i martesës, gruaja konsiderohet pors i nëna biologjike e fëmijës që ka ushqyer. Kështu, ajo tashmë është nëna e dytë e fëmijës, fëmijët e nënës janë vëllezër dhe motra me fëmijën e mëkuar, si dhe bashkëshorti i gruas konsiderohet babai i qumështit të fëmijës (leben el-fahl). Çdo dispozitë juridiko-fetare martesore ndërtohet një herë e përgjithmonë mbi këto gjykime. Kështu, fëmija i mëkuar pengohet një herë e përgjithmonë nga martesa me fëmijët e nënës së qumështit.

Një çështje e rëndësishme në jurisprudencën e gjidhënies është ajo që juristët e quajnë leben el-fahl (qumështi i burrit), që nënkupton se qumështi i gruas juridikisht lidhet edhe me bashkëshortin prej të cilit është shkaktuar shtatzënia dhe lindja. Për pasojë, jo vetëm gruaja që ushqen me gj bëhet nënë e qumështit, por edhe bashkëshorti i saj konsiderohet babai i qumështit.

Bazë për këtë është hadithi i njohur i Aishes (r.a.), kur Profeti (s.a.s.) urdhëroi që të njëhej lidhja e gjidhënies edhe nga ana e burrit, duke e konsideruar atë burim të farefisnisë së qumështit (Shih: Buhari, 5103; Muslim, 1445; Ebu Daud, 2057; Nesai, 3301).

Mbi këtë bazë, shumica e juristëve nga katër medhhebet pranojnë se ndalimet martesore nga gjidhënia shtrihen jo vetëm te të afërmit e gruas gjidhënëse, por edhe te të afërmit e bashkëshortit të saj. Prandaj, fëmija i mëkuar

nuk mund të martohet me fëmijët biologjikë të burrit nga martesa të tjera, pasi konsiderohen vëllezër e motra nga qumështi.

Lidhja e gjidhënies krijon pengesa vetëm për martesë mes disa të afërmeve të caktuar. Ajo nuk sjell pasoja të tjera juridike si e drejta e trashëgimisë, detyrimi i ushqimit dhe nevojave bazike financiare (nafaka) apo ndalimi i dëshmisë. Si dhe, nga aspekti i të afërmeve të gjakut të fëmijës, nuk ka asnjë efekt.

2. Baza fetare e gjidhënies

Çështja e gjidhënies është shumë e ndjeshme, për këtë arsye, dijetarët klasikë e kanë trajtuar këtë temë me kujdes të madh, duke u mbështetur në Kuran, Sunet dhe analogji juridike.

Bazat themelore të kësaj çështjeje gjenden në Kuranin Fisnik të shprehura në ajetet e mëposhtme:

...وَأَنْ أَرَدْتُمْ أَنْ تَسْتَرْضِعُوا أَوْلَادَكُمْ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِذَا سَلَّمْتُمْ مَا آتَيْتُمْ بِالْمَعْرُوفِ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ

"Po ashtu, nuk është gjynah për ju nëse doni t'i gjeni fëmijës suaj ndonjë mëndeshë, me kusht që t'ia jepni atë që e keni menduar, sipas rregullave. Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Allahu i sheh mirë të gjitha punët që bëni ju." (Bekara, 2:233)

وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ

që do të thotë: "Nënat le t'i ushqejnë fëmijët e tyre dy vite të plota..." (Bakara, 2:233). Ky ajat vendos periudhën kohore në të cilën gjidhënia ka efekt juridik. Ndërsa në një ajat tjetër thuhet:

وَأُمَّهَاتُكُمُ اللَّاتِي أَرْضَعْنَكُمْ وَأَخَوَاتُكُم مِّنَ الرَّضَاعَةِ

që do të thotë: "(Ju janë ndaluar për martesë) nënat tuaja që ju kanë dhënë gj dhe motrat tuaja nga gjidhënia..." (Nisa, 4:23). Ky tekst e bën të qartë se gjidhënia krijon një lidhje reale juridike që ndikon në martesë.

Këto ajete plotësohen nga hadithet profetike. Hadithi i Aishes (r.anha) sqaron edhe lidhjen me babain e qumështit: عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّهَا أَخْبَرَتْ: أَنَّ عَمَّهَا مِنَ الرَّضَاعَةِ يُسَمَّى أَلْفَحَ اسْتَاذَنَ عَلَيْهَا فَحَجَّجَتْهُ، فَأَخْبَرَتْ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ لَهَا: لَا تَحْتَجِّجِي مِنْهُ؛ فَإِنَّهُ يَحْرُمُ مِنَ الرَّضَاعَةِ مَا يَحْرُمُ مِنَ النَّسَبِ

Aishja (r.anha) tregon se xhaxhai i saj nga gjidhënia, i quajtur Eflah, kërkoi leje të hynte tek ajo, por ajo u mbulua (u tërhoq pas perdes) prej tij. Pastaj ajo e njoftoi të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të), dhe ai i tha: "Mos u mbulo prej tij, sepse nga gjidhënia ndalohet ajo që ndalohet nga farefisnia (e gjakut)." (Buhari, 5103; Muslim, 1445; Ebu Daud, 2057; teksti nga, Nesai, 3301)

Po ashtu, ai ka thënë: إِنَّمَا الرَّضَاعَةُ مِنَ الْمَجَاعَةِ

që do të thotë: "Gjidhënia (që ka efekt juridik) është ajo që ndodh në kohën e foshnjërisë (kur ushqimi është i nevojshëm)" (Buhari, 2647; Muslim, 1455; Ebu Daud, 2058).

لَا رَضَاعَةَ إِلَّا مَا كَانَ فِي الْحَوْلَيْنِ

"Nuk ka (efekt) gjidhënieje, veçse ajo që ka ndodhur brenda dy vjetëve" (Malik, el-Muvatta, 2/607; Bejhaki, el-Hilafijjat, 4705).

Këto hadithe sqarojnë se jo çdo gjidhënie ka efekt juridik, por ajo që ndodh në moshën e hershme.

Sa i përket vetë dhurimit të qumështit të gjirit, në parim ai është i lejuar në të gjitha medhhebet, sepse nuk ekziston ndonjë tekst që e ndalon në vetvete ushqyerjen e një fëmije nga një grua tjetër. Përkundrazi, në kohën e Profetit (s.a.s.) ishte praktikë e njohur që fëmijët të ushqeheshin nga gra të tjera, siç është rasti i Halime es-Sa'dijes, e cila ushqeui Profetin(s.a.s.).

3. Qasja e medhhebeve për shkakun e lidhjes së gjidhënies

Hanefitë dhe Malikitë e lejojnë dhurimin e qumështit të gjirit si veprim në vetvete, por vendosin kufij të qartë mbi pasojat e tij. Sipas shumicës së dijetarëve të fikhut, qumështi me të cilin fëmija ushqehet brenda dy viteve të para pasi lind, qoftë ushqyerje drejtpërdrejt nga gjiri apo nga një enë, qoftë pak apo shumë, është i mjaftueshëm për të krijuar lidhje farefisnore prej gjidhënies. Sipas kësaj, një vajzë dhe një djalë që janë ushqyer qoftë edhe një herë nga e njëjta grua brenda kësaj periudhe, nuk u lejohet të martohen me njëri-tjetrin. (Serahsi, el-Mebсут, 5/137; Kasani, Bedai', 4/8; Ibn Abidin, Radd el-Muhtar, 3/209–213; Ibn Rushd, Bidaje el-Muxhtehid, 3/59–60)

Ndërsa Shafitë dhe Hanbelitë ndjekin hadithin e Aishes (r.anha), sipas së cilës, për t'u krijuar lidhja e gjidhënies, është kusht që brenda dy viteve të para foshnja të ushqehet me gji pesë herë të ndara, ku çdo herë të arrijë ngopjen (Ibn Kudame, el-Mugni, 8/171; Shirbini, Mugni el-muhtaxh, 5/130–131; Mauerd, el-Haui el-kebir, 9/196–198).

Qasja tradicionale e dijetarëve ka qenë, që pavarësisht vlerës shpirtërore (sevapit) të kësaj vepre, gjidhënia të lejohet pikë së pari, në kushte domosdoshmërie, në rast pamundësie të gjetjes së qumështit të vlefshëm për fëmijët, siç mund tëndodhë tek foshnjat premature ose sëmundjet e nënës. Pikë së dyti, gruaja që dëshiron të kryejë këtë vepër të informojë më parë bashkëshortin e saj dhe të marrë dakordësinë e tij. Dhe së treti, të ketë patjetër dëshmitarë dhe të dokumentohet në formën më të të sigurtë. P.sh., nëse është mundësia të përpilohet një deklaratë me shkrim dhe të noterizohet. Nëse ka institucione që e njohin ligjërisht gjidhënien, atëherë të regjistrohet.

Ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e dijetarëve bashkëkohorë kanë kufizuar gjidhënien për të parandaluar problematika të mëdha, të cilat në vende të ndryshme të botës kanë shkaktuar pengesa martesore mes individësh, të cilët janë informuar shumë vonë për relatë për shkak të gjidhënies ose kanë shkaktuar divorce, për shkak se janë informuar pas martese, që kanë relata gjidhënieje. Ata janë bazuar në faktin se ditët e sotme, ka mundësi të tjera për të zëvendësuar qumështin e nënës, në rast se nëna nuk prodhon qumësht ose ka probleme shëndetësore, ndër të cilat edhe qumështi për fëmijë që këshillohet nga mjekët dhe mund të gjendet në farmaci.



4. Vërtetimi i gjidhënies

Farefisnia nga gjidhënia vërtetohet në dy mënyra kryesore: me ikrar (pranim/deklarim) dhe me bejjine (dëshmi). Ikrari nënkupton që burri dhe gruaja, ose njëri prej tyre, ta pranojnë ekzistencën e lidhjes së gjidhënies. Nëse deklarimi vjen vetëm nga gruaja, juristët kanë disa hollësi të veçanta mbi ndikimin e tij, sidomos kur burri nuk e pranon këtë pretendim.

Mënyra e dytë është përmes dëshmisë para gjykatës, ku shumica e medhhebeve pranojnë si standard dëshminë e dy burrave, ose një burri dhe dy grave. Megjithatë, ka mospajtime lidhur me dëshminë vetëm nga gratë: hanefitë nuk e konsiderojnë të mjaftueshme, ndërsa shafitë, hanbelitë dhe malikitë kanë qëndrime më lehtësuese dhe në rrethana të caktuara e pranojnë, pasi ajo është çështje që zakonisht njihet më shumë nga gratë.

5. Ndanimet martesore nga gjidhënia

Sipas shumicës së juristëve, për shkak të farefisnisë nga gjidhënia nuk lejohet martesë me kategoritë e mëposhtme:

a) Paraardhësit nga gjidhënia (nëna e gjirit, babai i gjirit, gjyshet e gjirit, gjyshërit e gjirit).

b) Pasardhësit nga gjidhënia (fëmijët e gjirit, nipërit e mbesat e gjirit).

c) Pasardhësit e nënës dhe babait të gjirit, qoftë përmes farefisnisë së gjakut apo asaj të gjidhënies. Këtu përfshihen edhe vëllezërit e motrat e gjirit nga i njëjti baba. Për shembull, nëse një burrë ka dy gra dhe njëra ushqen me gji një djalë, ndërsa tjetra një vajzë, këta konsiderohen

vëlla e motër të gjirit nga ana e babait dhe nuk mund të martohen me njëri-tjetrin.

d) Fëmijët e gjyshit dhe gjyshes së gjirit (halla e gjirit, xhaxhai i gjirit, teza e gjirit, daja i gjirit).

e) Paraardhësit nga gjidhënia të bashkëshortit/es (nëna e gjirit e bashkëshortes, babai i gjirit, gjyshet dhe gjyshërit e gjirit të saj/tij).

f) Pasardhësit nga gjidhënia të bashkëshortit/es (fëmijët e gjirit dhe nipërit/mbesat e gjirit të tij/saj).

g) Bashkëshortët e paraardhësve nga gjidhënia (bashkëshortët e nënës së gjirit, babait të gjirit, gjyshërve dhe gjysheve të gjirit).

h) Bashkëshortët e pasardhësve nga gjidhënia (bashkëshortët e fëmijëve të gjirit dhe të nipërve/mbesave të gjirit).

Dy gra që janë të afërta nga gjidhënia në atë mënyrë që, po të supozohej njëra burrë, martesë mes tyre do të ishte e ndaluar, nuk mund të mbahen njëkohësisht nën një nikah.

Sipas Ibn Tejmijes dhe Ibn Kajjim el-Xheuzijes, të afërmit krushqorë (sihri) të farefisnisë nga gjidhënia, domethënë ata që u përmendën te pikat e, f, g dhe h, nuk konsiderohen farefis nga gjidhënia. Po ashtu, sipas tyre, dy gra që janë të lidhura si farefis nga gjidhënia, është e lejuar të mbahen njëkohësisht nën një nikah.

6. Bankat e Qumështit

Bankat e qumështit të gjirit (milk banks) janë objekt debati të veçantë. Shumica e juristëve bashkëkohorë janë të rezervuar ose kundër tyre, sepse:

a) Qumështi i grumbulluar nga dhurues të shumtë dhe i dhënë fëmijëve të ndryshëm, mund të krijojë lidhje qumështi të pagjurmueshme dhe të fshehta mes familjesh të ndryshme. Kjo do të sillte rrezikun e martesave të ndaluara.

b) Konkluzione konkrete të institucioneve të të drejtës islame janë të mendimit se bankat e qumështit nuk lejohen, kur nuk ka mundësi identifikimi biologjik të fëmijëve që marrin qumësht, posaçërisht kur bashkohen shumë dhurues (Shih: Mexhma', Ndalimi i bankave të qumështit).

Dar al-Ifta egjiptiane ka dhënë një qasje më fleksibile, ku në disa raste e lejon konceptin e milk banks, sidomos në nevojë mjekësore (Shih: Dar el-Ifta, është is the legal opinion for establishing a bank for storing mothers' milk in a Muslim country?) Por kështu Diyaneti i Turqisë e lejon por me kushtëzime të shumta (Shih: Diyanet, "Anne Sütü Bankası" konusunda Diyanet'ten açıklama).

Për këtë arsye, një pjesë e madhe e tyre e ndalojnë këtë praktikë në formë anonime, ndërkohë që e lejojnë vetëm nëse identiteti i nënës dhe i fëmijës regjistrohet saktë dhe ruhet.

7. Rekomandime praktike

Nëse dikush dëshiron të dhurojë qumësht gjiri,

Të bëhet në rast domosdoshmërie jetike.

Të bëhet për fëmijë të identifikuar konkretisht.



Bashkëshorti i gruas dhuruese dhe prindërit e fëmijës të informohen plotësisht.

Të ruhet dokumentacion i datave dhe sasisë.

Të shmanget kontributi në banka anonime qumështi, sidomos kur nuk ka sistem gjurmimi.

Familjet e të dyja palëve të mbajnë shënime për të shmangur martesë problematike në të ardhmen.

8. Konkluzione

Bazuar mbi analizën e medhhebeve dhe primeve juridiko-fetare, mund të formulohen konkluzionet e mëposhtme:

a) Dhurimi individual dhe i dokumentuar preferohet të kufizohet në raste domosdoshmërie. Nëse një grua, në rast domosdoshmërie dhe mungese zgjidhjeje alternative, i dhuron qumështin e gjirit një fëmijë konkret, me dijeninë e të dyja familjeve dhe me dokumentim të saktë, kjo vepër konsiderohet e lejueshme. Për shafiitë dhe hanbelitë, nëse sasia mbetet nën pesë gjidhënie të plota, nuk ka as pasojë juridike.

b) Dhurimi anonim ose nëpërmjet bankave kolektive të qumështit është problematik dhe shumica e juristëve e kanë ndaluar atë. Rreziku i pasojave juridiko-fetare të fshehta është real dhe i vështirë për t'u menaxhuar.

c) Fëmijët e vegjël nën dy vjeç janë subjekti i vetëm i gjidhënies me efekt juridik. Dhurimi i qumështit për të rritur, p.sh., si ushqim apo ilaç, nuk krijon ndalime martesore (mahremijet).

Allahu di gjithçka më së miri

Një udhëtim mes dy dashurish

"Thuaju (o Muhamed): 'Nëse ju e doni Allahu, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet. Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirplotë.'" (Al Imran, 31)

Udhëtimi i njeriut drejt Zotit është përjetimi dhe përvoja më e bukur, i ngërthyer mes dy dashurish. Një udhëtim që nis me dashurinë për Zotin dhe finalizohet me dashurinë e mëshirën e Zotit ndaj tij. Kjo fe është feja e dashurisë. Aty ku s'ka dashuri, ku s'ka ndjenjë, ku s'ka botë shpirtërore, nuk ka as fe.

Që këto dy dashuri të ruajnë një lidhje reciprociteti mes tyre, kanë nevojë për një urë të vërtetë lidhëse dhe kjo urë lidhëse është udha që më i Dashuri i njerëzve shtroi për ne.

Udhëtimi ynë nis me një dashuri të vërtetë për Zotin, e cila na e bën të lehtë, të dashur dhe të bukur pasimin e udhës fisnike, duke na përcjellë si një puhizë e lehtë drejt dashurisë sublime, një dashuri në sajë të së cilës njeriu do të jetë reflektuesi i cilësive hyjnore në tokë.

Ashtu siç thotë edhe Zoti në një hadith kudsij:

"Robi Im do të vazhdojë të më afrohet Mua me vepra vullnetare, derisa ta dua. E kur ta dua, do të

bëhem syri me të cilin sheh, dora me të cilën prek dhe këmba me të cilën ecën."

A nuk e di akoma se kush është Zoti yt?!

Përgjatë viteve kam vënë re një dukuri tejet të dëmshme te ne. Kjo dukuri karakterizohet nga një mendim që e kam dëgjuar shumë shpesh. Më thonë: 'Mendoj se Zoti po më dënon për shkak të mëkateve që kam bërë'. Kur e dëgjoj këtë, i pyes: 'A je penduar për ato mëkate?' 'Po.' - është përgjigja që më jepet thuajse gjithmonë.

Mendoj se ka diçka që nuk shkon në gjithë këtë. Singerisht, ne nuk kemi arritur të kuptojmë akoma se kush është Zoti në të vërtetë. Një nga emrat e Tij është El-Afu'u (Falësi). Ky është edhe emri që Profeti a.s. ka porositur që ta përmendim sa më shumë, sidomos gjatë netëve të fundit të Ramazanit.

Shumë prej nesh e thonë vazhdimisht lutjen: 'O Allah, Ti je Falës, e do faljen, prandaj falna ne', por pak e dinë kuptimin e vërtetë të saj. Ky atribut i Zotit, nuk do të thotë se Zoti nuk i vë re mëkatet. Ky emër do të thotë se Ai i fshin ato. I fshin sikur të mos kenë ekzistuar kurrë më parë. Prandaj, kur ne pendohemi singerisht, kur i drejtohem Falësit, mëkati ynë fshihet, fshihet si të mos ketë qenë asnjëherë. E si mund të themi pra, se Zoti po na dënon për një mëkat tashmë të fshirë?!



Nëse doni të ndryshoni jetën, përmirësoni namazin tuaj

"Atyre që duan të ndryshojnë rrënjësisht jetën, u them që t'ia nisin me namazin. Vetëm kur ta kthesh sërisht namazin në prioritetin tënd, vetëm atëherë do të mund ta ndryshosh jetën tënde plotësisht. Shumë njerëz vetëmashtrohen duke menduar se në fillim duhet ta ndryshojnë jetën, e më pas të fillojnë të falen. Kjo mënyrë të menduari është një kurth i rrezikshëm i shejtanit, i cili e di mirë se është vetë namazi, ai që do të të ndryshojë jetën. Kjo situatë ngjan me shembullin e një shoferi, makina e të cilit është bosh, por ai këmbëngul që ta vazhdojë udhëtimin pa i hedhur asaj karburant. Ky njeri s'do të mund të arrijë dot në destinacion. Ngjashëm me të, disa njerëz qëndrojnë në të njëjtin vend për vite me radhë, pa u falur dhe pa ndryshuar asgjë në jetën e tyre. Shejtani i mundi ata, duke u vjedhur të paçmueshmen. Shtëpitë dhe makinat janë aq të shtrenjta për ne, sa që paguajnë shumë të mëdha për t'i siguruar. I mbrojmë pasuritë, por zemrat tona i lëmë të pambrojtura. I lëmë që të na i vjedhë më i keqi i vjedhësve, ai që është betuar përpara Zotit se do të jetë armiku ynë i pamëshirshëm deri në fund, i cili dëshiron të vjedhë shpirtin dhe biletën tonë të përhershme për në Parajsë."

Namazi është shtylla e Islamit

Pozita e namazit në Islam është si pozicioni i kokës në trup. Namazi është shtylla e Islamit, është pika mbështetëse e kësaj feje, është drektori i saj, është simboli i kësaj feje, është manifestimi i saj i përjetshëm dhe argument i fesë, derisa të ketë jetë në tokë. Gjithashtu, namazi është kënaqësia e syve, qetësia e ndërgjegjes, është shoqëruesi i shpirtit dhe gëzimi i zemrës, është lidhja mes robit dhe Krijuesit. Namazi është mjeti, me të cilin lartësohen zemrat e të dashuruarve për te pozita më e lartë (xheneti). Kështu që, i dashuruar begatohet në shoqërinë e këtij adhurimi, gëzohet dhe qetësohet në kopshtet e këtij vendi të shenjtë, në të cilin bashkohen shkaqet e lumturisë së botës së padukshme dhe të dukshme. Namazi është mjaltë që e përjeton ai që e shijon ëmbëlsinë e tij.

Pash Zotin, a ke parë diçka më të këndshme, më të ëmbël, më të arrirë dhe më të pastër sesa një person të përkushtuar dhe adhurues, i cili përkulet në sexhde, fal shumë namaz gjatë natës, ruhet nga ndëshkimi në botën tjetër dhe shpreson mëshirën e Zotit të tij, ndërkohë që sytë e të tjerëve flenë, apo qepallat u janë rënduar, trupat u janë qetësuar nëpër shtrate dhe çdo i dashuruar është veçuar me atë që do?!

Mënyrat e largimit të së keqes



“Nëse ndokush prej jush sheh një veprim të dënueshëm (munker), le ta ndalojë atë me dorë; nëse nuk ka mundësi, atëherë me fjalë; e nëse as këtë nuk mund ta bëjë, atëherë le ta kundërshtojë me zemër. Dhe kjo është shkalla më e dobët e besimit.”

(Muslim, Iman 78; Tirmidhi, Fiten 11; Nesai, Iman 17)

Kjo do të thotë se, kur ndonjëri prej jush përballet me një veprim që feja e konsideron të shëmtuar dhe të ndaluar, duhet që, nëse ka mundësi, ta largojë atë drejtpërdrejt me veprim. Nëse nuk është i aftë të ndërhyjë praktikisht, pra nuk mund të reagojë me veprim konkret, atëherë duhet ta kundërshtojë me fjalë të buta, me debat të bukur, me përpjekje të ndershme, si dhe me këshillë e predikim, pra përmes gjuhës. Nëse as kjo mënyrë nuk është e mundur, për shkak të mungesës së kushteve apo rrethanave të papërshtatshme, atëherë duhet ta urrejë atë veprim me zemër, sepse kjo përfaqëson nivelin më të ulët të besimit.

Mendoni sikur jeta jonë shoqërore të ishte e prekur

nga një mikrob që e gërryen shoqërinë nga brenda, një sëmundje që e dobëson dhe e shkatërron gradualisht atë. Zinaja, droga, fajdeja, spekulimi ekonomik dhe praktika të ngjashme janë shembuj të tillë. Armiqtë e shoqërisë dhe rrjetet e së keqes i mbajnë gjallë këto dukuri me kujdes të veçantë, ndërsa ju e shihni qartë se si shoqëria tronditet dhe bie në gjunjë përballë tyre.

Nëse shoqëria do të kishte një identitet të mirëfilltë Islam, atëherë do të pritej që shteti të garantonte rendin, disiplinën dhe sigurinë publike, të urdhëronte të mirën dhe të ndalonte të keqen, dhe në këtë rast individët e asaj shoqërie do të mund të thoshin, “eh, nuk mbetet më detyrë për ne.” Po ashtu, në një periudhë kur Islami kishte epërsi shoqërore, autoritetet ndërhynin, ushtria dhe forcat e rendit vepronin dhe nuk lejonin që veprimet e shëmtuara dhe dënueshme të përhapeshin në jetën shoqërore. Të gjitha këto janë forma të ndërhyrjes dhe ndalimit të së keqes me dorë. Mirëpo, në ditët e sotme, nuk është e mundur të ndërhyhet ndaj veprimeve të shëmtuara në këtë nivel, ashtu siç

nuk nxitet mjaftueshëm as e mira dhe e bukura. Sot, nëse në një ambient të çfarëdo i thua dikujt që po kryen një veprim të shëmtuar dhe ndaluar fetarisht "mos e bëj", ai jo vetëm që nuk të dëgjon, por mund të reagojë dhunshëm ndaj teje. Për këtë arsye, ndërhyrja me veprim i takon vetëm autoriteteve kompetente.

Njëherazi, ekziston edhe forma e ndalimit dhe kundërshtimit me fjalë. Nga njëra anë ti nuk ke mundësi të ndërhysh me veprim. Nga ana tjetër as shteti nuk e ka marrë mbi vete këtë përgjegjësi detyrë institucionale, pra nuk zbaton parimin e "urdhërimit të së mirës dhe ndalimit të së keqes", nuk promovon urdhrat e Allahut dhe nuk i ndalon veprimet që Ai i ka ndaluar dhe kështu, në një farë mënyre, i ka dhënë leje sëmundjeve që gërryejnë jetën shoqërore. Për shembull, brenda një sistemi ligjor kryhet hapur zinaja, konsumohet alkool dhe ushtrohet fajdeja. Nëse nuk ke mundësi të reagosh me veprim ndaj këtyre dukurive, atëherë detyra jote është t'i kundërshtosh ato me fjalë. Duhet t'u shpjegosh njerëzve, përmes këshillës së bukur, se fajdeja është një mikrob që shkatërron jetën shoqërore, se zinaja është si një kancer apo gangrenë që kalb shoqërinë. Duhet t'i largosh njerëzit prej tyre duke krijuar neveri, frikë dhe refuzim. Natyrisht, kjo duhet bërë me butësi, me fjalë të ëmbla dhe me metoda komunikimi që përputhen me frymën e Kur'anit.

Falë Zotit, sot këto çështje mund të diskutohen dhe të shpjegohen lirshëm. Megjithatë, ka pasur dhe mund të ketë vende e periudha kur as kjo nuk lejohet. Ka pasur kohë kur, përballë një vale të pandalshme të së keqes, njerëzit janë penguar të bëjnë çfarëdo reagimi. Madje, nëse dikush do të thoshte se kamata dhe alkooli janë sëmundje shkatërruese për jetën shoqërore dhe se duhet patjetër të gjendet një zgjidhje, mbrojtësit e sistemit mund të përgjigjeshin duke e akuzuar për imponim të normave fetare dhe ta heshtnin me forcë, duke e shënjestruar, dënuar apo eliminuar. Në një situatë të tillë, ajo që mbetet për t'u bërë është të mos krijosh relata me ata që veprojnë të keqen, përveç rasteve të këshillimit dhe udhëzimit, dhe të mbash në zemër një ndjenjë mospajtimi dhe shqetësimi ndaj veprimeve të tyre. Kjo përfaqëson nivelin më të ulët të besimit dhe detyrimit fetar. Përkundrazi, nëse dikush qëndron pranë atyre që kryejnë veprime të shëmtuara dhe ndaluara fetarisht dhe i sheh me mirëkuptim apo i pranon veprimet e tyre, kjo konsiderohet heshtje bashkëfajtoare. Madje, kjo mund të bëhet shkak për zbritjen e ndëshkimit hyjnor mbi tërë shoqërinë.

Duhet theksuar se një shoqëri mund të përfshihet në mëkate të mëdha dhe imoralitete të rënda, por nëse brenda saj ekziston një komunitet aktiv, dinamik dhe i përkushtuar që përpiket t'i largojë këto të këqija, atëherë ky komunitet vepron si një paratoner që largon fatkeqësitë dhe e shpëton shoqërinë nga ndëshkimi hyjnor. Në mungesë të një komuniteti të tillë, fatkeqësitë

mund të bien mbi shoqërinë pa pësuar asnjë pengesë. Për këtë arsye, një besimtar nuk mund të pajtohet apo të normalizojë marrëdhëniet me ata njerëz të një shoqërie të tillë të cilët kryejnë haptazi veprime të shëmtuara dhe ndaluara fetarisht. Megjithatë, një besimtar mund të mbajë relata dhe marrëdhënie me të gjithë njerëzit në një nivel të caktuar, madje edhe me ata që kryejnë imoralitete, por me qëllimin e vetëm për t'ua përcjellë bukuritë e Islamit dhe për t'i ndihmuar ata të dalin nga gjendja e tyre e keqe. Nëse ky kontakt bëhet vetëm për hir të Allahut, atëherë edhe vetë kjo marrëdhënie shndërrohet në adhurim.

Si përfundim, niveli më i dobët i besimit është kundërshtimi me zemër ndaj atyre që kryejnë veprime të ndaluara. Por, kjo ndjenjë mospajtimi duhet të shoqërohet me mençuri, butësi dhe metodë të drejtë, në mënyrë që mesazhi i Islamit të pranohet dhe të mos refuzohet. I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë se është urdhëruar jo vetëm të zbatojë detyrimet fetare, por edhe të menaxhojë dhe udhëheqë njerëzit me urtësi dhe drejtësi. Prandaj, jo me ashpërsi, por me butësi, dashamirësi dhe mirësi duhet t'u afrohem njerëzve, në mënyrë që mesazhi të mos shkaktojë reagim negativ. Për këtë arsye, Allahu i urdhëroi Profetët Musa dhe Harun që t'i flisnin Faraonit me fjalë të buta dhe të përkëdhelura. (Taha, 20/44) Vetëm kështu përpjekjet për të përhapur të vërtetën marrin kuptim dhe nuk shkojnë dëm.

Në thelb, një besimtar duhet të komunikojë dhe të veprojë gjithmonë për hir të Allahut, të durojë çdo vështirësi në rrugën e shpalljes së të vërtetës dhe, kur është e nevojshme, të dijë edhe të mbajë qëndrim kundërshtues për hir të Tij...



Dija dhe karakteri në epokën e inteligjencës artificiale

*"Testi për diturinë e mirëfilltë është në vetë njeriun."*¹

- S. M Nakib el-Attas

Zhvillimi i shpejtë i inteligjencës artificiale (AI) ka vënë në pikëpyetje disa prej supozimeve themelore mbi të cilat është ndërtuar arsimi modern. Nëse një sistem artificial tani mund të shkruajë ese, të përmbledhë libra, të formulojë argumente dhe të prodhojë përgjigje që, në nivel formal, ngjajnë me punën e një studenti ose studiuesi, atëherë lind një pyetje e thellë: çfarë duhet të jetë qëllimi i edukimit njerëzor? Sistemet arsimore dhe mësimdhënësit po alarmojnë se AI ka krijuar një krizë në sistemin universitar. Shumë institucione arsimore tani janë në hall se si të dallojnë punën origjinale dhe kreative të nxënësve nga ajo çfarë mund t'ju ofrojë intelijenca artificiale. Tani propozohen teknologji të reja që mund ta dallojnë një material studimi të përpiluar nga AI, nga ajo e vetë njeriut. Por a do jetë zgjidhje programe të reja teknologjike për AI, apo vetë AI-ja po na tregon diçka më shumë në kohën tonë?

Një artikull nga Michael Grove dhe Tom Harrison, "Educating What AI Cannot"² po tregon se në fakt AI po na tregon se AI nuk ka shkaktuar krizë, siç po mendohet, por ajo po na tregon për një krizë që tashmë ka qenë në sistemin arsimor modern. Universiteti modern ka rrezikuar ta reduktojë edukimin në prodhimin, matjen dhe certifikimin e njohurive dhe aftësive, ndërkohë që AI po tregon se e vetmja gjë që nuk mund të automatizohet lehtësisht është karakteri, gjykimi, përgjegjësia dhe urtësia praktike. Prandaj, thonë ata, a mos po ia tregon rrugën e vërtetë AI-ja

1. Sejjid Muhammed Nakib el-Attas, Hyrje në metafizikën e Islamit/Paraqitja e elementeve themelore të botëkuptimit islam, (Shkup: Logos-A, 2011), 125.

2. Grove, Michael, and Tom Harrison. 2026. "Educating What AI Cannot: Character and the Future of Higher Education." *British Journal of Educational Studies*, June, 1–26. doi:10.1080/00071005.2026.2678972.

edukimit bashkëkohor, ku edukimi moral duhet të rikthehet në qendër të arsimit të lartë.

Dhjetë shekuj më parë, një nga nxënësit e talentuar të Imam Gazzaliut i shkroi një letër mësuesit të tij se pavarësisht se kishte mësuar shumë shkenca të ndryshme, ai po ndihej i çorientuar se çfarë duhet të bënte me gjithë këtë dije dhe qindra libra përreth. Imam Gazzaliu i kthen përgjigje me një libër që njihet me titullin *Ejjuhe'l-veled*.³ Në këtë vepër, Gazzaliu i drejtohet nxënësit të tij duke e paralajmëruar se konceptimi i dijes që kufizohet në akumulimin e informacionit e bën të natyrshëm këtë huti. Për Gazzaliun, njeriu mund të zotërojë një sasi të madhe njohurish dhe megjithatë të mos ketë arritur qëllimin e vërtetë të dijes.

Një nga idetë qendrore të *Ejjuhe'l-veled* është se dija nuk mund të justifikohet vetëm përmes sasisë së saj. Imam Gazzaliu nuk e mohon rëndësinë e studimit; përkundrazi, vetë struktura e veprës i drejtohet një nxënësi që ka kaluar vite duke kërkuar dije. Problemi fillon në momentin kur njeriu beson se vetë zotërimi i njohurive është i mjaftueshëm për përsosmërinë ose vlerën e tij si njeri. Për Gazzaliun, ekziston një hendek i mundshëm midis asaj që njeriu di dhe asaj që ai është. Një person mund të njohë parimet morale, por të mos jetë i moralshëm; mund të flasë për urtësinë, por të mos jetë i urtë; mund të ketë dije fetare, por kjo dije të mos e ketë transformuar karakterin e tij. Për këtë arsye, dija duhet të kalojë nga niveli teorik në atë praktik. Vlera e saj matet edhe nga ndikimi që ushtron mbi jetën dhe sjelljen e njeriut.

Kjo kritikë merr një aktualitet të veçantë në epokën e inteligjencës artificiale. Grove dhe Harrison argumentojnë se AI e ka bërë më të dukshme një problem që arsimi modern e kishte tashmë: prirjen për ta identifikuar edukimin me produktet e matshme të tij. Një ese, një provim,

3. Muhammed ibn Ahmed el-Gazzali et-Tusi, *Ejjuhe'l-Veled*, (Bejrut: Daru'l-Menhexh, 2014, bot. dytë). Kjo vepër e shkurtër është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe.



një raport ose një projekt shpesh trajtohen si dëshmi të drejtpërdrejta të dijes së studentit. Por nëse AI mund të prodhojë disa prej këtyre produkteve në mënyrë të besueshme, atëherë vetë produkti nuk është më provë e mjaftueshme e të mësuarit.

Këtu shfaqet një paralelizëm i rëndësishëm me Gazzaliun. Nëse Gazzaliu paralajmëron kundër dijes që nuk shndërrohet në veprim ose nuk vjen si rezultat i veprimit, AI detyron universitetin bashkëkohor të përballet me një fenomen tjetër: prodhimin e pamjes së dijes pa garantuar procesin e të mësuarit. Një tekst mund të jetë i saktë, elegant dhe bindës, por kjo nuk dëshmon domosdoshmërisht se personi që e dorëzon atë ka menduar, ka gjykuar ose është formuar intelektualisht përmes procesit. Teza kryesore e Grove dhe Harrison është se AI mund të kryejë ose imitojë shumë prej detyrave që tradicionalisht janë lidhur me inteligjencën akademike, por ajo nuk mund të edukojë karakterin njerëzor në vend të njeriut. Pikërisht për këtë arsye, autorët argumentojnë se arsimi i lartë duhet t'i kushtojë një rëndësi më të madhe zhvillimit të virtyeteve morale, intelektuale, qytetare dhe praktike.

Kjo nuk nënkupton se karakteri është një lloj "shtese" morale që mund t'i bashkëngjitet arsimit pasi studenti të ketë fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme. Përkundrazi, argumenti i artikullit sugjeron se karakteri është pjesë e vetë

mënyrës se si njeriu përdor dijen. Një person mund të jetë teknikisht shumë i aftë, por nëse nuk ka gjykim, përgjegjësi dhe integritet, aftësia e tij mund të përdoret në mënyra të dëmshme ose të papërgjegjshme.

Në Ejjuhe'l-veled, edukimi nuk është vetëm një proces i mbushjes së mendjes me njohuri. Ai është një proces i formimit të vetes. Disiplina, vetëkontrolli, sinqeriteti dhe përputhja midis dijes dhe veprimit janë elemente thelbësore të këtij procesi. Imam Gazzaliu e paralajmëron nxënësin e tij se kërkimi i dijes dhe leximit të shumtë mund të ketë vetëm motive të përkohshme ose te dukshme, siç janë mburrja, fitimi i ndonjë pozite, paga e lartë, por në anën tjetër më të mund të synohet ngritja e virtyeteve, moralit të lartë dhe veprimi me atë dije sipas parimeve të Sheriatit.⁴ Nëse nxënësi ose studenti është i prirë nga synimet e para, atëherë ai e përdorë dijen drejt atyre. Kështu, kopjimi, mashtrimi, plagjiatura bëhen të pashmangshme. Në rastin e dytë, ai synon një riorientim të të gjitha dhuntive të vetës me atë që di.

Nëse do ta përkthenim këtë ide në gjuhën e debatit bashkëkohor mbi AI-në, mund të thoshim se pyetja nuk është vetëm: "A mund ta përdorë studenti AI-në?" Pyetja më e rëndësishme është: "Çfarë lloj personi bëhet studenti përmes mënyrës se si e përdor AI-në?" Kjo zhvendosje

4. Po aty, 44.

është thelbësore. Në vend që AI të trajtohet vetëm si problem i plagjiaturës ose i integritetit akademik, ajo mund të shihet si një provë për karakterin. Përdorimi i teknologjisë kërkon gjykim: kur është e përshtatshme ta përdorësh, kur duhet ta kufizosh, si duhet të verifikosh informacionin që prodhon dhe, mbi të gjitha, kush mban përgjegjësi për rezultatin përfundimtar?

Këtu hyn në lojë koncepti i urtësisë praktike. Grove dhe Harrison sugjerojnë se edukimi duhet të zhvillojë aftësinë e studentit për të gjykuar në situata konkrete, ku nuk ekziston gjithmonë një rregull i thjeshtë ose një përgjigje automatike. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në marrëdhënien me AI-në, sepse një sistem mund të ofrojë një përgjigje, por nuk mund të marrë përgjegjësi morale në vend të përdoruesit. Në këtë kuptim, AI mund të prodhojë një përgjigje, por nuk mund të bëhet moralisht përgjegjëse për të njëjtën mënyrë si një njeri. Pikërisht këtu shfaqet kufiri që artikulli e konsideron specifikisht njerëzor: karakteri nuk është vetëm ajo që dimë, por mënyra se si gjykojmë dhe veprojmë.

Duhet të kemi parasysh se tradita islame ka një koncept shumë më të gjerë për karakterin dhe qëllimin e tij përfundimtar. Karakteri në perspektivën islame nuk përfshinë vetëm aspektet sekulare, por dhe ato fetare. Ashtu si për vetë Gazzaliun, formimi i karakterit nuk mund të shkëputet nga një kuptim fetar i njeriut dhe i qëllimit të tij. Edukimi është i lidhur me pastrimin e vetes, marrëdhënien me Zotin dhe orientimin drejt një qëllimi që e tejkalon suksesin në këtë botë. Vepra dhe karakteri kanë një dimension shpirtëror që nuk reduktohet në mirëqenien individuale ose funksionimin e mirë të shoqërisë. Ai i shkruan nxënësit të tij:

“Dija pa veprim me të është çmenduri, e vepra pa dije as nuk mund të ndodhë. Mos harro se vetëm dituria nuk është në gjendje të largojë nga veprat e këqija, e as të të udhëzojë në bindje, e as të të shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit. Nëse sot nuk punon sipas ditorisë tënde dhe nuk mundohesh të kompensosh atë që të ka ikur në ditët e shkuara, nesër do të thuash: O Zot, na kthe në dynja, të bëjmë vepra të mira; por atëherë do të marrësh përgjigjen: I çmendur, po ti nga atje erdhe!”⁵

Grove dhe Harrison, nga ana tjetër, e ndërtojnë argumentin e tyre në një kornizë të etikës së virtutit dhe të suksesit njerëzor. Qëllimi është formimi i individëve që mund të jetojnë mirë, të gjykojnë me përgjegjësi dhe të kontribuojnë në të mirën publike. Karakteri ka një dimension moral

dhe qytetar, por artikulli nuk e vendos atë në të njëjtin horizont teologjik që e gjejmë te Gazzaliu, dhe në përgjithësi te vetë tradita islame.

Ky dallim është i rëndësishëm sepse tregon se nuk mund të transferojmë automatikisht konceptet nga një traditë në tjetrën. Për Gazzaliun, pyetja “çfarë lloj njeriu duhet të bëhem?” nuk mund të ndahet nga pyetja “për çfarë qëllimi ekziston njeriu?”. Në edukimin modern, pyetja është më shumë: “çfarë lloj qytetari dhe agjenti moral duhet të formojë universiteti në një botë të transformuar nga teknologjia?” Megjithatë, ky dallim nuk e dobëson domosdoshmërisht krahasimin. Përkundrazi, ai e bën atë më produktiv. Gazzaliu i jep debatit bashkëkohor një dimension që ndonjëherë mungon: pyetjen nëse formimi i karakterit mund të reduktohet vetëm në aftësi për funksionim të mirë shoqëror. Nga ana tjetër, Grove dhe Harrison e përkthejnë shqetësimin për formimin moral në një gjuhë institucionale dhe pedagogjike që mund të aplikohet konkretisht në universitetet moderne.

Megjithatë, kontributi më i rëndësishëm i Gazzaliut në këtë debat mund të jetë një pyetje edhe më radikale. Nëse arsimi bashkëkohor pranon se duhet të formojë karakterin, atëherë duhet të pyesë gjithashtu: çfarë është karakteri i mirë dhe mbi çfarë baze përcaktohet ai? Teknologjia mund të na detyrojë të rikthehemi te edukimi i karakterit, por nuk mund të na japë automatikisht përgjigjen se çfarë karakteri duhet të kultivojmë. Këtu e shoh të domosdoshme që institucionet tona arsimore fetare që ofrojnë edukim fetar do të luajnë një rol tejet kritik në këtë debat. Në një botë ku makinat mund të prodhojnë gjithnjë e më shumë informacion, argumente dhe tekste, ndoshta pyetja më e rëndësishme e edukimit nuk është më thjesht “çfarë mund të dijë njeriu?”, por “çfarë lloj njeriu duhet të bëhet ai me atë që di?”

Në këto sfida që po kalon sistemi arsimor në mbarë botën institucionet islame do kenë rolin më të madh të përfshihen në riorientimin e edukimit të së ardhmes. Tradita islame mund të japë një kontribut të rëndësishëm në riorientimin e edukimit bashkëkohor duke rikthyer idenë se arsimi nuk duhet të kufizohet vetëm në transmetimin e njohurive, zhvillimin e aftësive apo përgatitjen për tregun e punës, por duhet të synojë edhe formimin e njeriut në tërësinë e tij. Koncepti islam i ta'limit lidhet ngushtë me terbijen dhe te'dib,⁶ pra me edukimin, kultivimin dhe disiplinimin moral të individit. Në një kohë

6. Për raportin e këtyre dy koncepteve të shihet S.M. Nakib el-Attas, *The concept of Education in Islam*, (Kuala Lumpur: ABIM, 1978).

5. Po aty, 45-46.

kur AI mund të prodhojë informacion dhe të imitojë disa forma të inteligjencës, tradita islame e zhvendos vëmendjen nga pyetja "sa di njeriu?" drejt pyetjes "çfarë lloj njeriu bëhet ai përmes dijes së tij?". Në këtë kuptim, mendimtarë si Gazzaliu ofrojnë një perspektivë të vlefshme për arsimin bashkëkohor: dija duhet të shoqërohet me përgjegjësi, veprim, vetëdije morale dhe formim të karakterit. Kështu, tradita islame mund të kontribuojë në një konceptim më holistik të edukimit, ku njohuria, karakteri dhe përgjegjësia morale nuk trajtohen si dimensione të ndara, por si pjesë të së njëjtës përpjekje për formimin

e njeriut.⁷ Universiteti islam, medresetë dhe institucionet e tjera relevante tek ne duhet ta shfrytëzojnë këtë traditë të pasur pedagogjike për t'ju përgjigjur sfidave të një revolucioni të ri digjital.

1 shtator 2026/19 Rabiul-evvel 1448 H.

7. Për një trajtim të të gjitha këtyre aspekteve në edukimin islam të shihet Zahra al-Zeera, Tërësia dhe shenjtëria në edukim/Një perspektivë islame, (Tiranë: AIITC, 2019). Në këtë libër po ashtu trajtohet teoria e virtyteve dhe shpirtërores te imam Gazzaliu. Shih faqe 59 e tutje.



MODESTIA NË ISLAM, STOLIA E BESIMTARIT

Islami është feja e moralit, pastërtisë dhe dinjitetit. Ai nuk synon vetëm të rregullojë adhurimet e njeriut, por edhe karakterin, sjelljen dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët. Një nga virtytet më të çmuara që Islami e ka ngritur në një pozitë të lartë është modestia (haja). Ajo është një cilësi që e zbulon besimtarin, e ruan shoqërinë nga shthurja morale dhe e afron njeriun me Allahun e Madhëruar.

Në kohën tonë, kur shpesh promovohen mendjemadhësia, ekspozimi i tepërt dhe mungesa e turpit, nevoja për ta kuptuar dhe jetuar modestinë është më e madhe se kurrë.

Kuptimi i modestisë

Fjala arabe haja nënkupton turpin e lavdërueshëm, ndrojtjen për të bërë mëkat dhe ndjenjën që e shtyn njeriun të zgjedhë atë që është e drejtë. Modestia nuk është dobësi, frikë apo mungesë vetëbesimi. Përkundrazi, ajo është forcë e karakterit dhe vetëkontroll.

Besimtari është modest sepse është i vetëdijshëm se Allahu e sheh në çdo çast. Kjo vetëdije e mbron nga gjynahet dhe e shtyn drejt veprave të mira.

Modestia është pjesë e imanit

Profeti Muhamed ﷺ ka thënë:

"Modestia është pjesë e imanit."

Ky hadith tregon lidhjen e ngushtë ndërmjet besimit dhe modestisë. Sa më i fortë të jetë imani i njeriut, aq më shumë ai largohet nga sjelljet e pahijshme dhe nga çdo gjë

që e zemëron Allahun.

Në një hadith tjetër Profeti ﷺ tha:

"Çdo fe ka një tipar dallues, ndërsa tipari dallues i Islamit është modestia."

Prandaj modestia nuk është vetëm një cilësi e mirë, por një shenjë dalluese e besimtarit.

Modestia në Kuran

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"Thuaju besimtarëve të ulin shikimet e tyre dhe ta ruajnë dëlirësinë e tyre... Dhe thuaju besimtareve të ulin shikimet e tyre, ta ruajnë dëlirësinë e tyre..."

(Sureja En-Nur, 30-31)

Ky urdhër na mëson se modestia fillon nga zemra dhe shfaqet në shikim, në të folur, në sjellje dhe në veshje.

Po ashtu Allahu thotë:

"Mos ec në tokë me mendjemadhësi."

(Kuran, 17:37)

Kjo tregon se modestia përfshin edhe mënyrën se si sillemi dhe ecim mes njerëzve.

Shembulli i Profetit Muhamed ﷺ

Profeti ﷺ ishte njeriu më modest. Edhe pse ishte njeriu më i nderuar, ai jetonte me thjeshtësi. Ai ulej me të varfrit, vizitonte të sëmurët, pranonte ftesat e njerëzve të thjeshtë dhe nuk e konsideronte veten më të mirë se të tjerët.

Shokët e tij tregonin se modestia e Profetit ﷺ ishte



aq e madhe, sa ishte më i turpshëm se një vajzë e re në dhomën e saj.

Ai na mësoi se nderi nuk fitohet me pasuri, pozitë apo famë, por me devotshmëri dhe moral.

Llojet e modestisë

Modestia ndaj Allahut është që ta adhurojmë Atë me singëritet, t'u bindemi urdhreve të Tij dhe të largohemi nga ndalesat.

Modestia ndaj njerëzve shfaqet duke i respektuar, duke mos i ofenduar, duke mos i përcmuar dhe duke ruajtur të drejtat e tyre.

Modestia ndaj vetvetes është të mos e poshtërojmë shpirtin tonë me mëkate dhe sjellje që dëmtojnë dinjitetin tonë.

Si ta kultivojmë modestinë?

Të forcojmë lidhjen me Allahun përmes namazit dhe leximit të Kuranit.

Të kujtojmë se Allahu na sheh në çdo vend dhe në çdo kohë.

Të zgjedhim shoqëri të mirë, që na ndihmon në moral dhe devotshmëri.

Të flasim me edukatë dhe të shmangim fjalët fyese.

Të vishemi me dinjitet dhe të respektojmë udhëzimet islame.

Të ulim shikimin nga ajo që Allahu e ka ndaluar.

Të largohemi nga mendjemadhësia, mburrja dhe kërkimi

i lavdërimeve.

Dobitë e modestisë

Modestia e forcon besimin, e pastron zemrën, e mbron njeriun nga mëkatet dhe sjell respekt në shoqëri. Ajo forcon familjen, ruan nderin dhe krijon besim mes njerëzve. Një shoqëri ku mbizotëron modestia është më e qetë, më e pastër dhe më e drejtë.

Modestia në kohët tona

Sot jetojmë në një kohë ku rrjetet sociale dhe kultura e ekspozimit e bëjnë të lehtë humbjen e ndjenjës së turp. Besimtari duhet të jetë i kujdesshëm me atë që publikon, shikon dhe dëgjon. Modestia duhet të jetë e pranishme edhe në botën digjitale, sepse Allahu është dëshmitar i çdo fjale dhe veprë.

Modestia është një nga thesaret më të mëdha të besimtarit. Ajo e zbukuron njeriun në këtë botë dhe është shkak për shpërblim në botën tjetër. Le të përpiqemi ta zbatojmë këtë virtut në familje, në punë, në shoqëri dhe në çdo hap të jetës sonë.

Lusim Allahun e Madhëruar që të na pajisë me iman të fortë, me moral të lartë dhe me modesti në zemrat, fjalët dhe veprat tona. Allahu na bëftë prej robërve të Tij të singertë dhe na bashkoftë me Profetin Muhamed ﷺ në Xhenetin Firdeus. Amin

*Përse kjo botë quhet “bota e provës” dhe pse gjenden
kaq pranë njëra-tjetrës e mira dhe e keqja?*



I Gjithurti i Parapërjetësisë, ashtu siç e kërkon medoemos urtësia e Tij e parapërjetësisë dhe mirëbërësia e Tij e përjetshme, që e krijoi këtë botë që të jetë një vend prove, një arenë testimi; një pasqyrë e Emrave të Tij të Bukur, një faqe për penën e Paracaktimit Hyjnor dhe të fuqisë së Tij.¹ Tani prova dhe testimi janë shkaku i rritjes dhe i zhvillimit; dhe rritja e zhvillimi janë shkak për t'u zbuluar potencialet e bashkëlindura, dhe zbulimi i potencialeve është shkak për shfaqjen e prirjeve dhe të aftësive, dhe kjo shfaqje e aftësive u shkakton të vërtetave relative të bëhen të dukshme. Dhe të vërtetat relative duke u bërë të dukshme shkakton shfaqjen e qëndisjeve të manifestimeve të Emrave të Bukur të Krijuesit të Gjithëlavdishëm dhe transformimin e qënieve të universit në formën e mesazheve të përjetshme Hyjnore. Nëpërmjet këtij misteri të testimit dhe misterit të ngarkimit të njeriut me disa detyra që çojnë në pastrimin e esencave të shpirtërave të lartësuar të cilët janë si diamanti nga lëndët e shpirtërave të ulët që janë si qymyri, dhe të dy ndahen nga njëri-tjetri.

Kështu, meqenëse është për mistere të tilla si këto, dhe për shembuj të tjerë të hollë e të lartë urtësie, që ne akoma nuk i njohim, i Gjithëdituri i Gjithëfuqishëm e krijoi botën me këtë formë, dhe gjithashtu, Ai e deshi ndryshimin dhe transformimin e kësaj bote për ato shembuj të lartë urtësie. Ai i përziu bashkë të kundërtat me urtësi për ndryshimin dhe transformimin e saj, dhe i solli ato ballë për ballë. Duke bashkuar të dëmshmen me të dobishmen, duke përfshirë të keqen me të mirën, dhe duke përzier shëmtinë me bukurinë, Ai i gatoi të kundërtat së bashku si brumë, dhe e bëri universin t'i nënshtrohet ligjit të ndryshimit dhe shndërrimit, parimit të transformimit dhe të plotësimit.

Do të vijë një ditë kur ky vend testimi të jetë mbyllur, kur periudha e provimit të ketë përfunduar, kur Emrat Hyjnorë t'i kenë përmbushur dispozitat e tyre, kur Pena e Kaderit Hyjnor të ketë përfunduar shkrimin e mesazheve të saj, kur Fuqia Hyjnore të ketë plotësuar qëndisjet e artit të saj, kur qëniet të kenë përmbushur detyrat e tyre, kur krijesat të kenë kryer aktet e tyre të shërbimit, kur çdo gjë të ketë shprehur kuptimin e vet, kur kjo botë kalimtare të ketë prodhuar fidanet e Ahiretit, kur toka të ketë shfaqur dhe ekspozuar të gjitha mrekulitë e Fuqisë së Autorit të Gjithëfuqishëm dhe të gjitha çudirat e artit të Tij, dhe kur kjo botë e përkohshme t'i ketë bashkëngjitur

spangos së kohës tablotë që formojnë panoramat dhe pamjet e përjetësisë. Atëherë urtësia e përjetshme dhe mirëbërësia e Krijuesit të Gjithëlavdishëm bëjnë të domosdoshme që të shfaqen të vërtetat e rezultateve të atij testimi dhe rezultatet e shfaqjeve të Emrave të Bukur Hyjnorë, të vërtetat e atyre mesazheve të penës së Kaderit Hyjnor, origjinalet e atyre modeleve të qëndisjeve të Artit të Tij, qëllimet dhe dobitë e detyrave të qënieve, shpërblimet e akteve, të vërtetat e kuptimeve të atyre Fjalëve që shpreh libri i universit, mugullimi i farërave të përgatitjeve të bashkëlindura, hapja e dyerve të gjykatës më të lartë, shfaqja e pamjeve të marra nga kjo botë, grisja e perdeve të shkaqeve të jashtme të dukshme dhe nënshtrimi i çdo gjëje drejtpërdejt ndaj urdhërit të Krijuesit të Gjithëlavdishëm.

Dhe meqenëse urtësia e parapërjetësisë dhe mirëbërësia e përjetshme e Krijuesit të Gjithëlavdishëm i bëjnë të domosdoshme këto të vërteta, ato kërkojnë pastrimin e atyre të kundërtave me qëllim që të shpëtojnë botën nga ndryshimi dhe përkohshmëria, nga transformimi dhe zhdukja, dhe të ndajnë shkaqet e ndryshimit nga lëndët e konfliktit. Dhe sigurisht Krijuesi do të shkaktojë ringjalljen dhe do t'i pastrojë të kundërtat me qëllim që t'i shfaqë ato rezultate.

Kështu, si rezultat i këtij pastrimi, Xhehennemi do të marrë formën e tij të përjetshme e të tmerrshme dhe banorët e tij do të manifestojnë kërcënimin:

"Ndahuni këtë ditë (nga besimtarët), o kriminelë (mëkatarë)."²

Dhe Xhenneti do të marrë formën e tij madhështore e të përjetshme, ku njerëzit e tij dhe ata që janë të denjë për xhennet do të manifestojnë adresimin: **"(Dhe Ruajtësit e tij do të thonë): Paqja qoftë mbi ju! Punuat mirë, hyni pra, këtu për të banuar në të përgjithmonë."**³

Siç është provuar në pyejten e dytë të Stacionit të Parë të Fjalës së Njëzet e Tetë, nëpërmjet Fuqisë së tij të plotë, i Gjithurti i Parapërjetësisë do t'u japë banorëve të këtyre dy banesave trupa të përjetshme e të qëndrueshëm të cilët nuk do t'i nënshtrohen shpërbërjes e ndryshimit, pleqërisë apo zhdukjes, sepse nuk do të ketë atje shkaqe ndryshimi të cilat çojnë në zhdukje.

2. Kur'an, 36: 59

3. Kur'an, 39: 73.

1. Fjala e 29, Bediuzzaman Said Nursi.

Mëshira e Allahut

Thuaj: "Të kujt janë çka ka në qiej dhe në tokë?" dhe tregoj: "Të Allahut"! Ai ia ka caktuar vetvetes të jetë i mëshirshëm. Ai do t'iu tubojë juve në ditën e Kijametit, në këtë nuk ka dyshim..."¹

Njeriu ka ardhur në këtë botë me detyrën dhe qëllimin për të njohur Allahun dhe adhuruar vetëm Atë. Të vërtetat e universit, jetës së njeriut dhe hapat e tij në stacionet e jetës kalojnë nëpërmjet njohjes së Allahut nëpërmjet emrave të Bukur dhe Cilësive të Tij. Dhe e vërteta më e shndritshme që reflekton në fytyrën e universit dhe jetës njerëzore, një ndër emrat më të lartë dhe të pandashëm Allahut është Mëshira e tij e Pafundme.

Në thelbin dhe esencën e krijimit të universit qëndron Mëshira e Allahut. Nëse s'do të ishte mëshira e Tij asgjë nuk do të ekzistonte. Vazhdimësia e ekzistencës, jeta në tokë, bashkëpunimi mes gjallesave, funksionimi i çdo gjëje në formën më të përkryer është prej Mëshirës së Tij. Prej mëshirës së tij i gjithë zinxhiri ushqimor është në shërbim të njeriu si fryti i të gjithë universit. Prej mëshirës së Tij hidrogjeni dhe oksigjeni bashkohen për tu bërë ujë dhe burim i jetës. Prej mëshirës së Tij shiu që zbret pike-pikë prej qiellit është mëshirë dhe bereqet për njerëzit dhe jetën tokë dhe jo dënim e shkatërrim për ta.

Mëshira e Allahut është e atillë që Ai në fillimin çdo sureje ka vendosur të na prezantohet jo me dënimin, drejtësinë apo ndonjë cilësi tjetër por me Mëshirën e tij të Pakufishme. Imam Shafiu do të thoshte: **Edhe pse është një ajet, "Bismilahi" ka zbritur 114 herë në kuranin Fisnik.**

Në Kuranin Famëlartë gjendet një sure me emrin Mëshiruesi. Në këtë sure njeriut i përkujtohen mirësitë shumëllojshme të Zotit ndaj të cilave ai nuk duhet të jetë mosmirënjohës dhe përgënjeshtues. Thotë Allahu i Lartmadhëruar:

"Mëshiruesi. Ai ia mësoi Kur'anin. E krijoi njeriun. Ia mësoi atij të folurit."²

Allahu i Lartësuar i ka dhuruar njeriut mirësi dhe begati të panumërta. Mirësia më e madhe dhe rezonimi më i madh i Mëshirës së Tij është dërgimi i Kuranit si udhërrëfyes për njeriun në jetën e kësaj bote. Pa dritën Hyjnore njeriu nuk do ti jepte përgjigje pyetjeve ekzistenciale

1. Kuran, Enam, 6:12.

2. Kuran, Rrahman, 55:1-4.

që e kanë shqetësuar qenien njerëzore që prej fillimit të saj. Nuk do të njihte nga ka ardhur ku do të shkojë çfarë ka pas vdekjes dhe cila është detyra dhe qëllimi i ekzistencës së tij. Nëpërmjet Fjalës së Zotit njeriu do të njohë të mirën dhe të keqen, të gjejë të drejtën në këtë jetë. Dhe mbi të gjitha Kurani me mësimet e tij është rruga për komunikuar me Allahun, për të qetësuar zemrën dhe shpirtin tonë, për të njohur Zotin dhe gjetur veten tonë dhe për të jetuar në çdo moment të jetës në Hijen e Mëshirës, Bujarisë, Faljes dhe Mbrojtjes së Tij. janë një një oaz në shkretëtirën e kësaj bote për të freskuar shpirtin, për të folur me zotin dhe për të qenë gjithmonë pranë Tij.

Nëse Kurani është reflektimi më i madh i Mëshirës së Allahut, në botën njerëzore ai do ti zbritej atij që Allahu do ta quante si mëshirë për të gjithë botët, Muhamed Mustafasë a.s. Vetë ekzistenca e tij si i dërguar i Zotit për ti nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë është tregues i kësaj mëshire. Jeta e tij e përvuajtur për të përfaqësuar dhe mishëruar në formën më të lartë mesazhin hyjnor, deri në skajet e qenies së tij është tregues i kësaj mëshire. **"A mos vallë ti (o Muhammed) do ta shkatërrosh veten, ngase ata nuk duan të besojnë?"³**

Universi dhe çdo gjë në të është një pasqyrë e reflektimit të Emrave dhe Cilësive të Bukur të Allahut. Përtej perdes së materies çdo gjë është një rreze një reflektim i këtyre emrave që e përmend Zotin dhe është shenjë për njohjen e Tij për njerëzit që mendojnë. Nëse krijesat e ndryshme reflektojnë emra të caktuar të Allahut njeriu si njeriu si fryti i gjithë universit është qenia në të cilën reflektohet të gjitha cilësitë e bukura të Zotit. Duke menduar dhe medituar mbi veten njeriu do të njohë Zotin, do të njohë dobësinë, varfërinë dhe nevojën e Tij përballë mëshirës bujarisë dhe Madhështisë dhe do të përulet plot drojë dhe respekt para tij. Hz. Ali do të thoshte: *"Ti mendon se je një krijesë e vogël, ndërsa brenda teje është përmbledhur gjithësia."*

Tregohet një ngjarje në epokën e lumturisë, në kohën kur Profetit a.s. ishte te një moment pas mbarimit të një lufte. Një nënë e e shqetësuar po kërkonte fëmijën e saj në mesin e robërve. Pas shumë kërkimesh ajo gjen e përqafton dhe e merr pranë saj. Profeti a.s. njeriu i dhembshurisë, i prekur dhe i mallëngjyer përballë kësaj tabloje i

3. Kuran, Shu'ara, 26:3.

pyet sahabët e nderuar: A mendoni se kjo nënë mund ta hedhë fëmijën e saj në zjarr? Sahabët i përgjigjen: Jo o i Dërguar i Allahut. Cila nëna mund ta hidhte fëmijën e saj në zjarr. Dhe Profeti a.s tha: Allahu është më i mëshirshëm me robërit të saj, sesa kjo nënë për fëmijën e saj.

Në fakt është Allahu që prej mëshirës së tij të pakufishme ka vendosur atë mëshirë në zemrën e saj. Dhe e gjithë mëshira e zbritur në jetën e kësaj bote është vetëm një pjesë e vogël prej mëshirës së tij. Thotë: Profeti a.s: *"Ditën kur Allahu krijoi qiejt dhe tokën, Ai krijoi njëqind mëshira. Secila prej këtyre mëshirave është aq e madhe sa mbush hapësirën ndërmjet qiellit dhe tokës. Prej tyre, Ai zbriti vetëm një mëshirë në tokë. Falë kësaj mëshire, nëna tregon dhembshuri ndaj fëmijës së saj. Edhe kafshët e egra dhe shpendët sillen me mëshirë ndaj njërit-tjetrit. Kur të vijë Dita e Kiametit, Allahu do ta bashkojë këtë mëshirë me nëntëdhjetë e nëntë të tjerat dhe kështu do ta plotësojë mëshirën e Tij në njëqind."*

Një nga konceptet thelbësore në marrëdhënien mes njeriut dhe Zotit është Mëshira e Tij. Jeta e njeriu në këtë është një sprovë për të qëndruar në rrugën e drejtë dhe jetuar sipas mësimave hyjnore. Por njeriu në natyrën e tij, është një qenie që harron bie në gabime dhe mëkate dhe ka nevojë kthehet te mëshira e Allahut dhe falja e tij. Thotë Profeti a.s: **"Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë, por më i miri i gabimtarëve është ai që e kupton gabimin dhe kthehet prej tij"**.

Në një ajet tjetër Allahu i lartësuar thotë: **"Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni tepruar kundër vetes suaj, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Vërtet, Allahu i fal të gjitha gjynahet. Ai është Falësi i Madh, Mëshirëploti."**⁴

Mëshira e Allahut është e madhe dhe e pakufishme. Por njeriu duhet të kthejë zemrën drejt kësaj mëshire për të përfituar prej saj. Në një kuptim simbolik, dielli me dritën dhe ngrohtësinë përhapet në çdo anë të botës, duke i dhuruar dritë dhe ngrohtësi çdo gjëje. Por nëse njeriu "ia kthen shpinën" diellit, nëse qëndron në hije nuk do të përfitojë prej dritës dhe ngrohtësisë së tij. Ashtu edhe mëshira e Allahut është e pakufishme dhe e pafundme saqë përfshin gjithçka. Por për ta perceptuar atë siç duhet, për të ndriçuar jetën tonë dhe shpëtuar në jetën e përtejme njeriu duhet ta kthejë zemrën dhe mendjen drejt saj. Dhe sipas përpjekjes së tij njerëzore Allahu do ta përfshijë atë në Faljen dhe Mëshirën e tij hyjnore. Allahu i lartësuar thotë:

4. Kuran, Zumer, 39:53.

"...dhe mëshira ime ka përfshirë çdo gjë; atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët i ruhen mëkateve, e japin zekatin dhe për ata që argumentet tona i besojnë. Ata që ndjekin rrugën e Pejgamberit, lajmëtarit të fesë, i cili nuk di shkrim lexim (Muhammedi), të cilin ata e gjejnë të shënuar në Teurat dhe Inxhil."⁵

Mëshira e Allahut i prek të gjithë njerëzit besimtarë dhe jobesimtarë. Çdo njeri do të marrë një rreze nga mëshira e Allahut. Por çdo njeri do kuptojë dhe përjetojë mëshirën sipas thellësisë së Tij shpirtërore dhe lidhjes me Zotin e Tij.

Jeta e njeriu e njeriut është një përpjekje për të përvetësuar virtytet e larta dhe për tu edukuar me moralin hyjnor. Andaj për të fituar mëshirën hyjnore njeriu duhet të përvetësojë mëshirën në shpirtin e tij dhe në të gjitha dimensionet e jetës. Në një hadith shumë të njohur Profeti a.s thotë:

"Të mëshirshmit i mëshiron Mëshiruesi. Mëshironi ata që janë në tokë tju mëshirojë ai që është në qiell."

Vetë jeta e tij ishte një porsishte një simfoni e bukur e mëshirës. Vetëm nëpërmjet mëshirës dhe dhembshurisë së Tij ai zbuti zemrat më ngurta dhe njerëzit u mblodhën rreth Tij si fluturat rreth zjarrit. Mëshira e tij përfshinte jo vetëm njerëzit por të gjithë gjallesat deri te kujdesi për të mos shkelur një merimangë. Edhe pasuesit e tij, do ti përvetësonin këto vlera duke ndërtuar një qytetërim që do të reflektonte një shoqëri të mëshirshme dhe një model për të gjithë njerëzimin. Andaj le të jeta ndjenja e mëshirës, rrezatimi i saj në të gjitha dimensionet e jetës tonë rruga për të kërkuar dhe arritur Mëshirën e Pafundme të Gjithëmëshirshmit.

Dhe si përfundim krahas përpjekje për të qenë njerëz të mirë dhe të devotshëm nuk duhet humbim shpresën dhe mendimin e mirë për mëshirën e Pafundme të Allahut. Sepse mëshira e tij është më madhe se gjynahet tona. Dhe Zoti do ti shikojë njerëzit në ditën e kijametit sipas mendimit dhe besimit që ata kanë për Të.



5. Kuran, A'raf, 7:156-157.

Nga zemra te zemra Fryma e bujarisë në Islam

Të japësh nuk do të thotë vetëm të ndash nga pasuria. Bujaria e vërtetë është një gjendje e zemrës: të japësh nga ajo që ke, të ruash dinjitetin e tjetrit dhe ta shohësh çdo begati si amanet të Allahut. Bujaria dhe zemërgjerësia zënë një vend të veçantë në moralin dhe jetën shpirtërore islame. Njeriu mund të jetë bujar me paranë, por edhe me kohën, dijen, mundin, faljen, mikpritjen, dhembshurinë, kujdesin ndaj të tjerëve...

Arabët para Islamit e çmonin bujarinë, por shpesh ajo lidhej me krenarinë personale, famën dhe reputacionin fisnor. Profeti Muhamed ﷺ e ngriti bujarinë në një nivel shumë më të lartë: dhënie për Allahun dhe jo për lavdinë personale. Kjo na mëson një parim shumë të rëndësishëm. Mund të japësh shumë dhe të humbasësh vlerën shpirtërore të veprës për shkak të dyfaqësisë. Dhe mund të japësh shumë pak, por ajo pakicë të ketë një vlerë të jashtëzakonshme tek Allahu për shkak të sinqeritetit. Sepse Allahu nuk sheh vetëm shumën. Ai sheh zemrën që qëndron pas saj.

Në shkallën më të lartë, bujaria arrin deri aty sa njeriu të jetë i gatshëm ta vendosë nevojën e tjetrit përpara rehatisë së vet. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“Ata, të cilët pasurinë e vet e shpërndajnë në rrugë të Allahut natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk do të ketë frikë dhe as do të pikëllohen.”** (Bekare, 2:274)

Edhe Profeti Muhamed ﷺ e lidh vlerën e njeriut me dobinë që ai u sjell të tjerëve. Në një transmetim nga Abdullah ibn Omeri (r.a.) përcillet: *“Njerëzit më të dashur tek Allahu janë ata që u sjellin më shumë dobi njerëzve. Veprat më të dashura tek Allahu janë: t’i sjellësh gëzim një myslimani, t’ia largosh një brengë, t’ia shlyesh një borxh ose t’ia largosh urinë...”*

Islami nuk pyet vetëm: “Sa dhe?” Ai pyet edhe: “Pse dhe?” dhe “Si e dhe?” Pasuria është amanet, jo pronësi absolute. Një nga parimet që ndryshon rrënjësisht mënyrën se si besimtari e sheh pasurinë është vetëdija se pronari i vërtetë i çdo begatie është Allahu.

Kurani thotë: **وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ**...dhe japin nga ajo me të cilën Ne i kemi furnizuar.” (Bekare, 2:3) Vëmendja këtu duhet të ndalet te shprehja “nga ajo me të cilën Ne i kemi furnizuar”. Pasuria nuk paraqitet si diçka që njeriu e zotëron



në mënyrë absolute, por si një begati që Allahu ia ka besuar përkohësisht. Kjo e ndryshon edhe psikologjinë e dhënies.

Besimtari nuk mendon me krenari: “Unë i dhashë këtij të varfri.” Ai mendon: “Allahu më dha mua dhe më bëri shkak që një pjesë e mirësisë së Tij të arrijë te ky njeri.” Kjo vetëdije e mbron bujarinë nga mendjemadhësia dhe, në të njëjtën kohë, ruan dinjitetin e nevojtarit.

Nëse dikush jep për famë, për t’i krijuar tjetrit një detyrim moral apo për t’i kujtuar vazhdimisht: “Unë të kam ndihmuar”, ndihma mund të shndërrohet në plagë. Ndërsa ai që jep për hir të Allahut nuk kërkon që marrësi t’i nënshtrohet, ta lavdërojë apo t’i mbetet borxhli moralisht.

Tre pyetje duhet t’i bëjmë vetes para se të japim: Pse po jap? Për Allahun apo për t’u parë nga njerëzit? Si po jap? Duke ruajtur dinjitetin e tjetrit apo duke e poshtëruar? Çfarë pres pas dhënies? Shpërblim nga Allahu apo mirënjohje nga njerëzit?

Gjithashtu, bujaria dhe ekonomia nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën. Në pamje të parë mund të duket sikur bujaria dhe kursimi janë të kundërta. Në të vërtetë, ato mund të

plotësojnë njëra-tjetrën. Ekonomi ndaj vetes do të thotë më shumë mundësi për bujari ndaj të tjerëve. Ndërsa shpërdorimi dhe luksi i tepërt shpesh e bëjnë njeriun më pak të gatshëm për të ndihmuar.

Ai që i sheh begatitë si dhurata dhe amanete të Allahut nuk i shpërdoron ato. Ai e di se ajo që sot harxhohet pa nevojë mund të ishte nesër ushqim për një familje, libër për një nxënës, ilaç për një të sëmurë apo mbështetje për një njeri në vështirësi. Prandaj zemërgjerësia nuk nënkupton papërgjegjshmëri ekonomike. Ajo nënkupton: Mos e harxho kot atë që mund të shndërrohet në mirësi për dikë tjetër.

Në etikën islame ekziston një shkallë edhe më e lartë se dhënia e zakonshme: altruizmi (ithari). Altruizëm do të thotë ta parapëlqesh tjetrin ndaj vetvetes, madje edhe kur vetë ke nevojë. Pra, nëse do ta përmblihdnim, bujarinë mund ta kuptojmë në tri shkallë:

Bujaria – t'i japësh tjetrit nga ajo që ke, pa ndier ngushtësi në zemër.

Bamirësia – ta lidhësh lumturinë tënde me lumturinë e njerëzve të tjerë.

Altruizmi – ta parapëlqesh tjetrin ndaj vetes edhe atëherë kur vetë ke nevojë.

Këtë shkallë të lartë shpirtërore Kurani e përjetësoi në përshkrimin e Ensarëve të Medinës: **"...u japin përparësi atyre ndaj vetvetes, edhe pse vetë janë nevojtarë." (Hashr, 59:9)**

Kur myslimanët e Mekës emigruan në Medinë, shumë prej tyre lanë pas shtëpitë, tregtinë, tokat dhe pasuritë. Ata mbërritën në një qytet të ri me shumë pak nga ajo që kishin pasur më parë. Ensarët e Medinës nuk i pritën vetëm si mysafirë. I pritën si vëllezër. Ata ndanë me ta shtëpitë, ushqimin, mundësitë ekonomike dhe jetën e përditshme. Kështu, vëllazëria islame kaloi nga fjalët në realitet. Ensarët na mësojnë se bujaria nuk varet gjithmonë nga sa shumë zotëron njeriu, por nga sa shumë është i gatshëm të ndajë.

Bujaria nuk matet vetëm me atë që jep, por edhe me atë që je i gatshëm të sakrifikosh. Një sofër, një mysafir dhe një natë pa ushqim është historia e një sahabiu ensar, e cila përbën një nga shembujt më prekës të altruizmit.

Një njeri i urituar erdhi te Profeti Muhamed ﷺ. Në shtëpitë e vet ai nuk kishte ushqim për t'i ofruar. Atëherë ai iu drejtua shokëve të tij dhe pyeti se kush do ta merrte atë njeri si mysafir. Një prej Ensarëve tha: "Unë, o i Dërguari i Allahut." Ai e mori mysafirin në shtëpi dhe e pyeti bashkëshorten nëse kishin ndonjë ushqim. Ajo i tha se kishin vetëm aq sa për të ushqyer fëmijët. Sahabiu i kërkoi t'i vinte fëmijët në gjumë. Pastaj, kur të uleshin në sofër, ta fiknin dritën dhe të bënin sikur edhe ata po hanin. Mysafiri hëngri dhe u ngop. Ndërsa të zotët e shtëpisë e kaluan natën të uritur. Të nesërmen, Profeti ﷺ e përgëzoi familjen për atë që kishte bërë, duke treguar kënaqësinë e Allahut me veprimin e tyre. (Buhariu, Muslimi)

Bujaria afatgjatë sot mund të jetë: një bursë për arsimimin e një nxënësi, një bibliotekë, mbështetja e një

shkolle apo institucioni edukativ, mbjellja e pemëve, botimi i një libri të dobishëm, ndihma për ngritjen e një institucioni që u shërben njerëzve etj.

"Nuk kam para" nuk do të thotë "nuk mund të jem bujar" Shpesh njeriu mendon: "Unë nuk kam para, prandaj nuk mund të jem bujar." Por bujaria islame është shumë më e gjerë se pasuria. Nëse nuk ke para, mund të japësh: kohën, dijen, mundin, përvojën, këshillën, mbështetjen morale, një fjalë të mirë, një buzëqeshje, një vizitë, një lutje. Mund të jesh pranë dikujt në çastin kur ai ka nevojë për një njeri që ta dëgjojë. Edhe kjo është bujari.

Ta marrim një shembull nga koha jonë. Një njeri me shumë pasuri dhuron qindra euro. Një mësues me të ardhura modeste kalon çdo javë disa orë falas me një nxënës të varfër që rrezikon të braktisë shkollën. Ai e ndihmon, e motivon dhe nuk e lë të humbasë të ardhmen e tij. Cili prej tyre është më bujar? Nuk mund të japim një përgjigje vetëm duke numëruar paratë. Sepse bujaria matet edhe me atë sa nga vetja jemi të gatshëm t'i japim tjetrit. Për dikë njëqind euro mund të jenë shumë pak. Për një tjetër, dy orë nga koha e tij mund të jenë një sakrificë e madhe. Vlerën e vërtetë të çdo dhënieje e di Allahu.

Ekziston edhe një formë bujarie që nuk kushton asnjë monedhë, por ndonjëherë është më e vështirë se të japësh pasuri: Të falësh. Profeti Jusuf (a.s.) është një shembull madhështor i kësaj zemërgjerësie. Vëllezërit e tij e hodhën në pus, e ndanë nga babai, u bënë shkak që të shitej si skllav dhe që të përjetonte sprova të shumta. Pas shumë vitesh, kur Jusufi (a.s.) kishte pushtet dhe ata që e kishin dëmtuar qëndronin përpara tij, ai kishte mundësi të hakmerrej. Por nuk zgjodhi hakmarrjen. Ai tha: **"Sot nuk ka qortim për ju. Allahu ju faltë." (Jusuf, 12:92)**

Kjo është zemërgjerësi shpirtërore. Sepse njeriu nuk është koprrac vetëm kur nuk jep para. Mund të jetë koprrac edhe me faljen. Me dashurinë. Me mirënjohjen. Me komplimentin. Me dijen. Me kohën. Ndonjëherë, t'i falësh dikujt një gabim është një nga dhuratat më të mëdha që mund t'i bësh.

Si përfundim, Mos e shiko pasurinë që ke si pronë absolute. Shikoje si amanet. Mos e poshtëro nevojtarin kur jep, sepse Pronari i vërtetë i asaj që jep është Allahu. Mos kërko që dora që merr prej teje të mbetet e përlulur përpara teje. Përkundrazi, falëndero Allahun që të dha mundësinë që dora jote të bëhej shkak për një mirësi.

Mos u mjafto vetëm duke dhënë nga teprica. Syno atë pjekuri të zemrës ku gëzimi i tjetrit bëhet edhe gëzimi yt, ku dhimbja e tij të prek edhe ty dhe ku nevoja e tij bëhet shqetësim i zemrës sate. Sepse bujaria e vërtetë nuk është vetëm: të hapësh dorën. Është: të hapësh zemrën. Dhe kur një zemër hapet për hir të Allahut, mirësia nuk mbetet vetëm ndërmjet dhënësit dhe marrësit. Ajo kalon nga një njeri tek tjetri. Nga një familje tek një tjetër. Nga një brez tek brezi tjetër.

Bujaria e vërtetë ndërton besim, vëllazëri, dhembshuri dhe shpresë. Ajo udhëton: Nga zemra te zemra.

Dashuria e vërtetë



Vajza e vogël, teksa ecte përbri nënës së saj, u ndal përnjëherësh. Një biçikletë në rrugë i tërhoqi vëmendjen. Në të kishin hipur një burrë dhe e bija, e cila kishte pak a shumë të njëjtën moshë. Vajza ishte ulur mbrapa, sipër një ndenjeseje të vogël. Ajo mbahej fort pas të atit për të mos u rrëzuar. Fjalët që thoshte herë pas here i ati, duke kthyer kokën prapa, e bënë vogëlushen të qeshte.

Ndërsa vajza e shikonte nga pas biçikletën, e ëma i tha:

- Mesa duket biçikletat që ke në shtëpi të duken pak, por nëse të pëlqeu, babai të blen edhe një si kjo.

- Unë nuk po shikoja biçikletën, por vajzën, - ia ktheu vajza e vogël me zë të butë. - Edhe në atë pozicion madje, i ati po bisedonte me të.

E ëma sikur nuk e dëgjoi aspak të bijën. I rregulloi kapelën që mbante mbi kokë dhe i tha:

- Shokët e tu për të shkuar në shkollë ecin në këmbë, kurse babai yt, edhe pse i duhet të shkojë në punë, i rezervon disa minuta për të të çuar ty me mercedes.

Sytë e vajzës ishin përqendruar te biçikleta. Gruaja vazhdoi përsëri me qesëndi:

- Po deshe, edhe ty mund të të çojë babi me biçikletë, apo nuk i shkon?!

Vajza, teksa mendohej të fshihte nga e ëma lotët që i rridhnin si margaritarë, iu përgjigj:

- Sa shumë do të doja! Mbase ashtu do ta shtrëngoja fort babin tim.

Fati i mirë

Një mesoburrë vendosi makinën e vet, model i fundit, buzë detit dhe nisi të provonte grepin që e kishte sjellë nga jashtë. Megjithëse ishte një burrë me fat, nuk po zinte dot qoftë edhe një peshk.

Pak më vonë, pranë tij u afrua një peshkatar i ri. I riu, i cili nga veshja kuptohej që ishte shumë i varfër, nxori nga qesja kallamin, peri i të cilit qe bërë një në disa vende dhe grepat me përmasa të ndryshme.

Burri i pasur, me gëzimin që tashmë e gjeti zbavitjen për të larguar mërzinë, vështronte tjetrin dhe buzëqeshi kur pa se për një moment tjetri u emocionua. Në majë të grepit, që e tërhiqte me shpejtësi, me siguri që ishte kapur ndonjë gjë tjetër. Por pas pak, u habit nga ajo që i panë sytë. Një qefull, të paktën gjysmë kilogrami, tundej në majë të grepit. I riu e nxori peshkun, e vendosi në një qese të pastër dhe pas pesëmbëdhjetë minutash zuri një peshk tjetër. Burri i pasur nuk kishte parë kurrë diçka të tillë. Gjëja e quajtur "rastësi", kjo duhej të ishte. Ndërsa rrinte e tunde më kot grepin e tij që flakërinte, pa se i riu zuri edhe peshkun e tretë. Menjëherë brofi në këmbë dhe iu drejtua atij duke i thënë:

- Me një grep kaq të keq, s'e kuptoj si peshkon?! A më thua se ku qëndron sekreti i kësaj?

I riu u mjaftua me peshqit që zuri. Teksa po mblidhte ngadalë gjërat e tij, tha duke buzëqeshur:

- Sekreti i kësaj qëndron te vogëlushët e mi, të cilët iu lutën Zotit që unë të kapja peshq. Ka kaq ditë që ata nuk janë ngopur.

Lulet nuk rriten pa vesë, zemrat nuk rriten pa lot

Kur toka të jetë veshur me lule e bletët
me to të jenë takuar
Dhe poshtë rrënjëve të tyre, trupi i
mbjellë të më jetë thelluar
E bukur do të bëhet stina nga malli i
atyre që më deshën
Të bukura do të jenë të qarat e atyre që
me mua qeshën
Aq sa do të ndihet mungesa, ka vlejtur
prania në botë
Lulet nuk rriten pa vesë, zemrat nuk
rriten pa lot
Për hir të nektarit, bletët në lule
dashurohen
Por mjaltin bëjnë, veç kur nga lulet
largohen
Unë mbetem në ty, aq sa ti je në mua
Mjalti merret në lule, por bëhet veç në
zgjua.

Ku ka ndezje, ka dhe dritë

S'ka zemër që nuk ka dritë
S'ka dritë që s'dëbon errësirën
Po s'guxove ta ndezësh zemrën
Për shkak të keqes, ndëshkon të mirën
Dhe ti je vetë e mira
Që je këtu për të ndriçuar
Një kandil që kurrë nuk ndizet
Veten ka për ta ndëshkuar
Dritës i mjafton vetvetja
Të tjerët për të rrëfejnë
Nëse ti nuk i gjen fluturat
Ato vetë do të të gjejnë
Ti nuk je një i humbur
Në një vend që nuk e njeh
Ti je vetë vendi i duhur
Ama ndizu dhe e sheh
Në besim lind çdo dyshim
Siguria është në shpirt
Mos beso, ji sigurt.



FILLUAN REGJISTRIMET

Në Institutin e Studimeve
Islame: "Hafiz Sabri Koçi"

Viti akademik
2026-2027

Regjistrimet janë të hapura për
meshkuj dhe femra, **15-45 vjeç**



Kuran



Hadith



Tefsir



Fikh



Hitabet



Moral Islam



Akide



Histori Islame



WWW.KMSH.AL



KONTAKT

+355 69 663 0308